



STRATEGJIA  
NDËRSEKTORIALE  
E SHOQËRISË  
SË INFORMACIONIT





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT

# STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE PËR SHOQËRINË E INFORMACIONIT 2008-2013



# PASQYRA E LËNDËS

<b>LISTA E SHKURTIMEVE</b>	<b>7</b>
<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	<b>8</b>
<b>KAPITULLI I. GJENDJA AKTUALE</b>	<b>11</b>
1. Infrastruktura e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit dhe sektori i komunikimit postar	11
1.1 Infrastruktura e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit	11
1.2 Situata aktuale në sektorin e komunikimit postar	13
2. Qeverisja elektronike (e- Government) dhe shërbimet publike (e-services)	14
2.1 Qeverisja Elektronike	14
2.2 Shërbimet publike (e-services)	14
3. Edukimi dhe njohuritë	16
3.1 e-Edukimi	16
3.2 Projekte në fushën e Kërkimit shkencor mbi TIK	16
3.3 Edukimi i publikut dhe biznesit mbi TIK	17
4. e-Biznesi	18
5. Kuadri ligjor për shoqërinë e informacionit	19
6. Prirjet e zhvillimit të sektorit TIK në Shqipëri	19
<b>KAPITULLI II. VIZIONI, PËRPARËSITË DHE QËLLIMET STRATEGJIKE</b>	<b>23</b>
<b>KAPITULLI III. POLITIKAT QË DO TË NDIQEN</b>	<b>27</b>
3.1 Zhvillimi i infrastrukturës së Teknologjisë së Informacionit	27
3.2 Nxitja e qeverisjes së mirë përmes shërbimeve online moderne	29
3.3 Politikat në fushën e edukimit dhe njohurive	33
3.4 Politikat në drejtim të biznesit elektronik (E-Biznes)	34
3.5 Kuadri ligjor dhe institucional	35
3.5.1 Legjislacioni për shoqërinë e Informacionit	35
3.5.2 Kuadri institucional për zhvillimin e shoqërisë së informacionit	35
3.5.3 Një shoqëri informacioni e sigurtë	36
<b>KAPITULLI IV. BURIMET E FINANCIMIT, MONITORIMI DHE VLERËSIMI</b>	<b>39</b>
4.1 Burimet e financimit	39
4.2 Mekanizmi i implementimit, monitorimit dhe vlerësimit	39
4.3 Monitorimi dhe vlerësimi	39
4.4 Treguesit për zhvillimin e teknologjisë së informacionit	40
4.5 Raportimi	41
Aneksi 1	42
Aneksi 2	43
Aneksi 3	46
Aneksi 4	51
Aneksi 5	52



# LISTA E SHKURTIMEVE

SHKURTIMI	EMËRTIMI I PLOTË
<b>AKSHI</b>	Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit
<b>AKEP</b>	Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
<b>ADSL</b>	Asymmetric Digital Subscriber Line (linje dixhitale asimetrike e abonentit)
<b>ASYCUDA</b>	Sistemi automatik i përpunimi të të dhënave doganore
<b>APP</b>	Agjencia e Prokurimit Publik
<b>BB</b>	Banka Botërore
<b>BE</b>	Bashkimi Europian
<b>bSEE</b>	Broadband South Eastern Europe
<b>DAP</b>	Departamenti i Administratës Publike
<b>DBSKNH</b>	Departamenti i Strategjive dhe Koordinimi i Ndhmës së Huaj
<b>DPT</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
<b>EMIS</b>	Sistemi i informacionit për menaxhimin e arsimit
<b>E Government</b>	Qeverisja elektronike
<b>e-services</b>	Sherbime elektronike
<b>e- biznesi</b>	Biznesi elektronik
<b>eSEE</b>	Europa Juglindore elektronike (Electronic South Eastern Europe)
<b>EDGE</b>	Enhanced data rates for GSM evolution (transmetimi i avancuar i te dhenave per zhvillimin GSM)
<b>ERT</b>	Enti Rregullator i Telekomunikacioneve
<b>EMS</b>	Sherbimi i shpejte postar
<b>EUROSTAT</b>	Statistical Office of the European Communities (Zyra e Statistikave e Komunitetit Europian)
<b>GPRS</b>	General Packet Radio Service (sherbim radio me pakete)
<b>GovNet</b>	Government Network (Rrjeti qeveritar)
<b>IMS</b>	Sistemi i menaxhimit te informacionit (Information Management System)
<b>INSTAT</b>	Instituti i Statistikave
<b>ISP</b>	Internet Service provider (Ofruesi i sherbimit Internet)
<b>ITU</b>	International Telecommunications Union (Bashkimi Nderkombetar i Telekomunikacioneve)
<b>ISSH</b>	Instituti i Sigurimeve Shoqerore
<b>ISKSH</b>	Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor
<b>KE</b>	Komisioni Evropian
<b>KM</b>	Këshilli i Ministrave
<b>LLU (ULL)</b>	Unbundle local loop (akses i hapur ne rrjetin lokal)
<b>LSMS</b>	Anketimi për Matjen e Standardeve të Jetesës (Living Standard Measurement Survey)
<b>MASH</b>	Ministria e Arsimit dhe Shkences
<b>MB</b>	Ministria e Brendshme
<b>METE</b>	Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës
<b>MPÇSSH</b>	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
<b>MPPTT</b>	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve
<b>MSA</b>	Marrëveshja e Asocim Stabilizimit (Stabilization Association Agreement)
<b>MTKRS</b>	Ministria e Turizmit, Kultures, Rinise dhe Sporteve
<b>NVM (SME)</b>	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (Small and Medium Enterprise)
<b>OECD</b>	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
<b>PAP</b>	Pika te Aksesit per Publikun (Public akses point)
<b>POP</b>	Pike e prezences (Point of present)
<b>PKI</b>	Public key infrastrukture
<b>PBA</b>	Programi Buxhetor Afatmesem (Medium-Term Budget Programe)
<b>QKR</b>	Qendra Kombetare e Regjistrimit
<b>SEMD</b>	Sistemi elektronik per kontrollin e gjendjes gjyqesore
<b>SKZHI</b>	Strategjia e Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
<b>TIK</b>	Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit (Information and Communication Technology )
<b>TVSH</b>	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
<b>3G</b>	Gjenerata e trete e rrjeteve te telefonise se levizshme
<b>VKM</b>	Vendim i Keshillit te Ministrave
<b>VoIP</b>	Telefonia ne internet (Voice over IP)
<b>UN</b>	Kombet e Bashkuara
<b>UNDP</b>	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (United Nations Development Program)
<b>xDSL</b>	Teknologji qe ofrojne transmetimin e te dhenave dixhitale
<b>WSIS</b>	World Summit on Information Society (Samiti Boteror per Shoqerine e Informacionit



# PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Shqipëria është e vendosur në rrugën e saj për anëtarësim në Bashkimin Europian dhe në NATO, dhe ka ndërmarrë një sërë reformash të nevojshme për t'u afruar sa më shumë me standardet ndërkombëtare dhe europiane. Modeli evropian i zhvillimit është modeli i një ekonomie të bazuar në njohuritë dhe në shoqërinë e informacionit. Nën këtë shembull dhe atë të Strategjisë së Lisbonës për një Europë elektronike, vendet e Europës Juglindore nënshkruan në Tetor të vitit 2002 një axhendë të përbashkët eSEE (electronic South Eastern Europe) duke e parë modernizimin dhe përdorimin e teknologjive të reja, si dhe mundësitë për zhvillim që ato ofrojnë si një rrugë të shpejtë zhvillimi.

Shqipëria e ka rikonfirmuar angazhimin e saj për të ecur drejt rrugës së funksionimit të një ekonomie të bazuar në njohuritë dhe krijimin e një shoqërie të informacionit, përmes nënshkrimit në tetor të vitit 2007 të eSEE Agenda+ së bashku me vendet e tjera të Europës Juglindore. Kjo agendë e përbashkët rajonale u nënshkrua nën frymën e planit të veprimit të Bashkimit Europian i2010 për shoqërinë e Informacionit. Angazhimet e marra në këto dy dokumenta përbëjnë një sfidë të madhe për Shqipërinë, nëse marrim parasysh gjendjen aktuale të zhvillimit të sektorit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) në Shqipëri.

Ky dokument bazohet në Strategjinë Kombëtare për TIK të miratuar me VKM Nr. 216 datë 10.4.2003, e cila përfshinte 14 objektiva dhe kishte përcaktuar disa masa prioritare për të bërë të mundur zhvillimin e TIK në Shqipëri. Një pjesë e këtyre objektivave ende nuk janë realizuar, duke sjellë nevojën e hartimit të një strategjie të re që i përgjigjet më mirë nevojave dhe realitetit.

Në vitet e fundit është bërë një progres i ndjeshëm, në drejtim të qeverisjes elektronike, lehtësimit të biznesit përmes kryerjes së shërbimeve on-line, reformave të ndërmarra në kuadër të përmirësimit të regjimit rregullator, si regjistrimi i biznesit përmes ngritjes së Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit, në drejtim të edukimit përmes krijimit të kabineteve të informatikës nëpër shkolla, informatizimit të shërbimeve në dogana e tatime. Po kështu është rritur edhe ndërgjegjesimi për përfitimet nga teknologjia e informacionit dhe shkalla e përdorimit të internetit nga bizneset dhe qytetaret sidomos për brezin e ri.

Strategjia Ndërsektoriale për Shoqërinë e Informacionit 2008-2013, mbështetet në modelet dhe praktikatat më të mira europiane, përsa i përket objektivave dhe zgjidhjeve të parashikuara, gjithnjë duke marrë në konsideratë karakteristikat specifike të shoqërisë dhe ekonomisë shqipe.





tare. Qëllimi i kësaj strategjie është të rishikojë dhe të koordinojë detyrimet që lindin nga angazhimet e marra për krijimin e shoqërisë së informacionit me qëllim që të sigurohet përmbushja e përgjegjësive nga të gjithë aktorët në mënyrë të koordinuar. Strategjia konsideron si faktor kyç të suksesit për formimin dhe zhvillimin e shoqërisë së informacionit rritjen e përdorimit të teknologjive të informacionit dhe shikon zhvillimin e infrastrukturës për teknologjinë e informacionit si çelësin e zbatimit të suksesshëm të saj.

Në zbatim të qëllimit të mësipërm në strategji janë përcaktuar fushat prioritare bashkë me objektivat e përgjithshëm që synohen të arrihen. Fushat kryesore prioritare janë infrastruktura, qeverisja elektronike dhe shërbimet publike, edukimi dhe njohurite, e-biznesi dhe kuadri ligjor. Kjo strategji është e shoqëruar dhe me një plan veprimi bashkëngjitur strategjisë.

Dokumentat kryesore ku është mbështetur Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin e shoqërisë së informacionit 2008-2013 janë:

- Deklarata e përbashkët e nënshkruar nga ven-

det e Europës Juglindore në kuadrin e Paktit të Stabilitetit në Qershor 2002


- Axhenda për zhvillimin e shoqërisë së informacionit nënshkruar në tetor 2002
- Memorandumi për bSEE (broadband South Eastern Europe)
- Plani i veprimit dhe Deklarata e Samitit Botëror të Shoqërisë së Informacionit WSIS 2003
- eEuropa Action Plan dhe inicitivën i2010 të BE
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013 (SKZHI)
- Axhenda e-SEE plus, e nënshkruar në tetor 2007

Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit si institucion qendror i ngritur pranë Këshillit të Ministrave luan rol të rëndësishëm në koordinimin e politikave për zhvillimin e shoqërisë së informacionit, zbatimin dhe monitorimin e strategjisë.



KAPITULLI

# 1



# GJENDJA AKTUALE

## 1. INFRASTRUKTURA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT DHE SEKTORI I KOMUNIKIMIT POSTAR


### 1.1 INFRASTRUKTURA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT

Infrastruktura kombëtare e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit është shtylla kryesore e Shoqërisë së Informacionit. Në kuptimin e saj më të gjerë, ajo përfshin telekomunikacione me tela, pa tela, me satelit, rrjete kompjuterash, sisteme transmetimi dhe komutimi, televizion dixhital, një diapazon të gjerë të pajisjeve terminale, gjithashtu, programe informatike dhe aplikime, bazat e të dhënave elektronike dhe librari dixhitale.

Sektori i telekomunikacioneve në Shqipëri është i liberalizuar dhe numri i operatorëve që ushtrojnë veprimtari në këtë fushë është rritur ndjeshëm. Në vitin 2007 operatori kombëtar i shërbimeve publike telefonike fikse, Albtelecom sh.a. u privatizua (76%). Albtelecom ka një infrastrukturë mbarëkombëtare me një sistem transmetimi dhe komutimi pothuajse 100% të dixhitalizuar. Ky operator ofron edhe shërbime interneti me dial-up në të gjitha qytetet e vendit dhe ADSL në qytetet kryesore, por cmimet e ofrimit të këtij shërbimi janë relativisht të larta.

Penetrimi telefonik fiks është shumë i ulët dhe në fund të vitit 2007 llogaritet rreth 10%. Për këtë arsye edhe mundësia e përfitimit nga teknologjitë e brezit të gjerë sikurse janë ato xDSL është e reduktuar. Një pengesë tjetër në këtë drejtim mund të konsiderohet edhe shfrytëzimi i LLU (akses i hapur në rrjetin lokal) dhe mungesa e konkurrencës për ofrimin e shërbimeve xDSL që ka për pasojë nivelin relativisht të lartë të tarifave për ofrimin e këtyre shërbimeve.

Në figurën e mëposhtme jepet një shpërndarje gjeografike e lidhjeve ADSL<sup>1</sup>.




<sup>1</sup> Sipas të dhënave të Albtelecom



Dy operatorët e telefonisë së lëvizshme Albanian Mobile Communications dhe Vodafone Albania kanë pasur rritje të ndjeshme në periudhën 2001-2007 duke e çuar shkallën e penetrimit telefonik për tregun e telefonisë së lëvizshme në masën mbi 70%<sup>2</sup>. Por studimet<sup>3</sup> e bëra për këtë pjesë të tregut të telekomunikacioneve tregojnë se tarifatat për shërbimet e ofruara janë më

të larta në krahasim me vendet e tjera të rajonit. Operatori i tretë i telefonisë së lëvizshme Eagle Mobile, pjesë e paketës së privatizimit të Albtelecom sh.a. filloi ofrimin e shërbimit në muajin mars të vitit 2008. Hyrja në treg e këtij operatori do të rrisë konkurrencën në tregun e telefonisë së lëvizshme dhe pritet të ketë ndikim pozitiv në përfitim të konsumatorit.

Në figurën e mëposhtme paraqitet ecuria në vite e penetrimit telefonik fiks dhe celular në vend<sup>4</sup>.



Operatorët e telefonisë së lëvizshme ofrojnë dhe shërbimin GPRS dhe EDGE. GPRS është i mundshëm në të gjithë vendin ku ka mbulim me shërbim celular, ndërsa EDGE është futur pjesërisht. Pavarësisht se këto shërbime mund të konsiderohen të shtrenjta, ofrimi i këtij shërbimi bëhet mbi bazën e tarifimit për sasinë e informacionit të transferuar. Për aplikime që kanë transaksione të vogla është kost-efektive.

Duke filluar nga viti 2000, në tregun e telekomunikacioneve filluan operimin dhe operatorët publikë të telekomunikacioneve në zonat rurale, me të drejtë ofrimin e shërbimit publik telefonik të qëndrueshëm vetëm në zonat rurale. Zona më e vogël e licensimit ishte komuna. Edhe pse numri i këtyre operatorëve u rrit vit pas viti, kufizimet ligjore për ofrimin e shërbimit vetëm në zonat rurale bënë që rezultatet në rritjen e penetrimit të telefonisë fikse dhe në përmirësimin e infrastrukturës në këto zona të mos ishin të ndjeshme. Megjithatë këta operatorë bazuar në numrin e përdoruesve telefonike, zotërojnë rreth

11% të tregut të telefonisë fikse në vend. Ndryshimet ligjore të bëra në fund të vitit 2006, lejuan ofrimin e shërbimit telefonik nga këta operatorë dhe në zona urbane e ndërrbane mbi bazën e parimit të neutralitetit teknologjik. Numri i operatorëve alternative të telefonisë fikse lokale dhe rajonale në fund të vitit 2007 ishte 61<sup>5</sup>.

Numri i ofruesve të shërbimit Internet është rritur ndjeshëm. Deri në fund të vitit 2007, numri i të licensuarve nga ERT për ofrimin e shërbimit Internet ishte 32<sup>6</sup> nga të cilat një operator backbone, 15 ISP kombëtare, 2 rajonale, 9 lokale dhe 5 POP. Ndër ofruesit më të mëdhenj të shërbimit internet në vend mund të përmendim: Abcom, Albania Online, Abissnet, Albtelecom, Pronet, etj. Nuk ka të dhëna të sakta mbi numrin e përdoruesve Internet, por sipas vlerësimit të INSTAT<sup>7</sup>, numri i përdoruesve Internet në vitin 2005 është 120 408. Numri i përdoruesve të internetit vlerësohet të jetë rritur ndjeshëm vitet e fundit si rezultat i rritjes së shkallës së ndërgjegjimit për teknologjitë TIK dhe përfitimet e ofruara prej saj.

<sup>2</sup> Të dhënat për korrik 2008, raporti i Cullen-International "Report 1 Supply of services in monitoring regulatory and market developments for electronic communications and information society services in enlargement countries" September 30, 2008

<sup>3</sup> Burimi ERT: Analiza e tregut të telefonisë celulare: [www.ert.gov.al](http://www.ert.gov.al)

<sup>4</sup> Burimi ERT: Analiza e tregut të telefonisë fikse: [www.ert.gov.al](http://www.ert.gov.al)

<sup>5</sup> Burimi ERT: [www.ert.gov.al](http://www.ert.gov.al)



Sipas statistikave për teknologjinë e informacionit të publikuara nga ITU<sup>6</sup>, numri i përdoruesve të Internetit në Shqipëri në fund të vitit 2006, vlerësohet në 471 200 dhe penetrimi i Internetit 14.98%. Sipas disa të dhënave paraprake nga disa ofrues të shërbimit internet, treguesi i rritjes për numrin e përdoruesve të internetit në vitet e fundit vlerësohet në masën 30%-40%. Klientët më të mëdhenj dhe përdoruesit kryesorë të Internetit mbeten institucionet shtetërore dhe kompanitë e biznesit.

Vlerësimet e bëra për gadishmërinë elektronike për vitin 2005, e rendisnin Shqipërinë për disa tregues të gatishmërisë elektronike ndër vendet e fundit nga 115 vende të marra në konsideratë (shih: Aneksin 5). Vlerësimi i vitit 2008 tregon që Shqipëria ka bërë një përparim të dukshëm në disa tregues të gatishmërisë elektronike, kështu treguesi i gatishmërisë për e-government e rendit Shqipërinë në vendin e 86 ndër 182 vende të konsideruara ndërkohë që për vitin 2005, ky tregues ishte në vendin 102.

## 1.2 SITUATA AKTUALE NË SEKTORIN E KOMUNIKIMIT POSTAR

Operatori publik postar në tregun shqiptar të postave është "Posta Shqiptare" sh.a., e cila siguron një gamë të gjerë shërbimesh tradicionale postare (postën e letrave, kolipostën dhe shërbime të urdhërpagesave), shërbimin e shpejtë EMS, shërbime biznesi si dhe shërbime financiare (transferta të shpejta të parave, pagesat e tatim-taksave, shpërndarje të pensioneve të pleqërisë, arkëtimi i faturave të telefonisë dhe energjisë, ujit e pagesa të tjera). Aktivitetin e saj kjo kompani e zhvillon duke u mbështetur në një rrjet prej 541 zyrash postare dhe agjentesh postarë, nga të cilat 118 gjenden në qytete, 302 në qendra komune dhe 121 në fshatra. Infrastruktura e zyrave dhe gjeografia e shtrirjes së tyre përbejnë avantazhin konkurrues të kësaj kompanie në ofrimin e shërbimeve postare si dhe në thithjen e shërbimeve të reja. Gjithashtu në tregun postar ofrojnë shërbimet e tyre, kryesisht shërbime ekspres dhe operatorë me kapital privat, veprimtaria e licencuar e të cilëve, që nga viti 2001 shtrihet kryesisht në qytetet kryesore të vendit me një rrjet prej 60 zyrash postare.

Prezantimi i teknologjive të reja të informacionit dhe komunikimit është një kërkesë për shfaqjen

e llojeve tërësisht të reja të shërbimeve me vlerë të shtuar me një përqindje të lartë teknologjike. Ofrimi i shërbimeve të reja dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimit janë të lidhur direkt me rinovimin teknologjik të infrastrukturës postare kombëtare. Për këtë do të ndërtohen sistemet e mëposhtme për kryerjen e operacioneve.

- Gjurmimi dhe kërkimi me anë të bar-code të objekteve
- Automatizimi i sporteleve
- Informatizimi i shërbimeve
- Gjurmimi dhe sigurimi i automjeteve të postës
- Operimi me sistemin European të EUROGIRO.

**Problemet kryesore** me të cilat përballet sektori i infrasktrukturës së TIK në Shqipëri mund të përmbledhen në:

- Penetrimi tepër i ulët i telefonisë fikse
- Penetrimi i ulët i përdoruesve të Internetit
- Numri ende i ulët i kompjuterave personalë (PC) në familje
- Çmime të larta të telefonisë së lëvizshme
- Çmime të larta për aksesin në internet dhe përdorimin e shërbimeve të internetit
- Shkallë e ulët e ndërgjegjësimit për përdorimin dhe përfitimet e TIK në familje si pasojë e mungesës së njohurive dhe edukimit të nevojshme për këtë
- Hendek dixhital në krahasim me vende të tjera të zhvilluara
- Ndarje e thelluar dixhitale ndër-rajonale midis qyteteve kryesore dhe pjesës tjetër të vendit
- Të ardhura të ulëta për banorë/familje;
- Mungesa e politikave dhe praktikave shtetërore subvencionuese
- Literature e pamjaftueshme në gjuhën shqipe mbi TIK

Megjithë përmirësimet e viteve të fundit në fushën e TIK, mungesat teknologjike mbeten në nivel të konsiderueshem, mbulimin i të gjithë territorit me internet duhet rritur dhe ka nevojë për infrastrukturë të rrjetit të shpejtë dhe të besueshëm. Kjo tregon se duhet rregulluar një vemendje e vecantë në drejtim të nxitjes së zhvillimit të infrastrukturës së TIK si bazë për mbështetjen, zhvillimin e transformimin e shoqërisë drejt një shoqërie të informacionit.

<sup>6</sup> Burimi ERT: [www.ert.gov.al](http://www.ert.gov.al)

<sup>7</sup> Burimi: INSTAT/LSMS 2005

<sup>8</sup> Bashkimi Nderkombetar per Telekomunikacionet, [www.itu.int/ITU-D/ict/ey](http://www.itu.int/ITU-D/ict/ey)



## 2. QEVERISJA ELEKTRONIKE (E- GOVERNMENT) DHE SHËRBIMET PUBLIKE (E-SERVICES)

### 2.1 QEVERISJA ELEKTRONIKE

Qeverisja elektronike është një proces i gjatë i cili kalon nëpër disa faza të tilla si shpërndarja e informacionit në rrugë elektronike përmes prezencës në web deri te, transformimi i plotë i mënyrës së qeverisjes përmes ofrimit të shërbimeve publike online në mënyrë të sigurtë, të besueshme, lehtësisht të aksesueshme dhe me një pjesëmarrje aktive të qytetarëve dhe biznesit.

Qeverisja elektronike në Shqipëri është në fazat e para të zhvillimit të saj por disa nga arritjet e deritanishme janë:

- Rrjeti qeveritar GOVNET, i realizuar me mbështetjen e UNDP dhe Komisionit European. Në sajë të këtij projekti, ministritë, departamentet e qeverisë shqiptare si edhe dy organizata të shërbimit publik (gjithsej 26 institucione) janë lidhur përmes një rrjeti me fibër optike të shpejtësisë së lartë. Aktualisht zhvillimet e këtij rrjeti kanë bërë të mundur përdorimin e programeve të mëposhtme:
- Planifikimi i buxhetit afat mesëm (PBA).
- Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore nga DAP(HRMS).
- Sistemi elektronik për kontrollin e gjendjes gjyqësore të qytetarëve i Ministrisë së Drejtësisë (SEMD).
- Të gjitha ministritë kanë faqen e tyre të internetit dhe një bazë të dhënash elektronike ku prezantohen aktet ligjore dhe nënligjore, të rejat mbi aktivitetin e çdo ministrie, dokumenta strategjike duke realizuar kështu shpërndarjen e informacionit në rrugë elektronike. Publikimi elektronik i fletorezave zyrtare dhe legjislationit si dhe ofrimin e shërbimit elektronik për deklarimin e gjendjes gjyqësore.
- Kompjuterizimi dhe monitorimi i zbatimit të angazhimeve të marra nga qeveria në kuadrin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit. Në informatizimin e procesit të vlerësimit të ecurisë së zbatueshmërisë së MSA dhe procesit të përafrimit të legjislationit tregohet kujdes për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të teknologjisë së informacionit (IT) për mundësimin e shërbimeve "on line"

në informimin për ecurinë e procesit të integritetit. Me mbështetjen e GTZ, është ngritur një sistem informacioni për çmimet e produkteve bujqësore, kryesisht perime dhe fruta në disa tregje të mëdha të vendit si Tiranë, Korçë, Fier etj. Të dhënat e përpunuara hidhen në faqen zyrtare të ministrise, por ky sistem nuk ofron shërbime online.

- Ka përfunduar sistemi i informacionit të kontrollit kufitar në 14 pika kalimi kufitare.
- Krijimi i një sistemi bashkëkohor të gjendjes civile me anë të kompjuerizimit të regjistrave themeltare;

Puna e deritanishme në drejtim të shpërndarjes së informacionit në rrugë elektronike ka ndikuar pozitivisht për rritjen e transparencës në qeverisje. Qeveria është angazhuar në një program të gjerë reformash që synojnë rritjen e transparencës, luftën kundër korrupsionit dhe llogaridhënien.

Një kujdes i veçantë po tregohet nga qeveria për krijimin e infrastrukturës së shoqërisë së informacionit dhe veçanërisht në realizimin e pajisjes së qytetarëve me karta identiteti dhe pasaporta elektronike (PKI).

Nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit është bërë vlerësimi i situatës së infrastrukturës së TIK në administratën qendrore nga ku janë nxjerrë dhe nevojat për përmirësim të saj. Krahas ecurisë së deritanishme në drejtim të qeverisjes elektronike janë vërejtur edhe një sërë problemesh dhe nevojash për përmirësim të mëtejshme:

- Rritja e ndërgjegjësimit dhe e njohurive në të gjitha nivelet e administratës publike për rëndësinë e përdorimit të teknologjisë së informacionit në procesin e qeverisjes elektronike për një qeverisje më të mirë;
- Përmirësimi i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit për administratën publike;
- Përcaktimi i standarteve me qëllim rritjen e efektivitetit në punë dhe uljen e kostove operacionale;
- Rritja e kapaciteteve, burimeve njerëzore të teknologjisë së informacionit dhe kualifikimi i vazhdueshëm të tyre.

### 2.2 SHËRBIMET PUBLIKE (E-SERVICES)

Shërbimet publike dhe efektiviteti i shpërndarjes së tyre kanë një efekt të madh në zhvillimin ekonomik social të një vendi. Në procesin e trans-



formimit të shoqërisë në një shoqëri të informacionit ofrimi i këtyre shërbimeve nëpërmjet teknologjive të informacionit, në mënyre efektive, të shpejtë, transparente, të sigurtë dhe në përputhje me nevojat dhe kërkesat e qytetarëve dhe biznesit, është shumë e rëndësishme.

- Prokurimet publike dhe prokurimi elektronik. Ligji i ri për prokurimet publike mundëson prokurimin elektronik. Platforma e prokurimit elektronik është një aplikim i bazuar në rrjet, që mbështet automatizimin e aktiviteteve të tenderimit. Ky sistem mundëson transaksionet ndërmjet institucioneve publike shqiptare dhe komunitetit kombëtar e ndërkombëtar të biznesit. Sistemi ofron përgatitje dhe administrim të sigurt, efikas e transparent të të gjithë dokumentave që lidhen me procesin e tenderimit, duke mënjeluar formën e dorëzimit të dokumentacionit në letër dhe duke siguruar një rrjedhë të sigurt të të dhënave përgjatë gjithë procesit. Platforma e prokurimit elektronik është një pikë aksesi për të interesuarit, biznesin, për të gjitha ministritë e linjës dhe autoritetet kontraktore. Operatorët ekonomikë mund të përdorin shërbimet e ofruara për të lokalizuar garat e prokurimit dhe për të marrë pjesë në to në një formë tërësisht elektronike.

- Projekti me financim nga Banka Botërore për sistemin kompjuterik të financave publike (sistemi i thesarit), të buxhetit të shtetit si dhe të borxhit ka përfunduar. Gjithashtu është parashikuar edhe hartimi dhe plotësimi i legjislacionit përkatës lidhur me parandalimin e pastrimit të parave dhe ndërtimin e teknologjisë së informacionit. Për menaxhimin e riskut financiar është krijuar Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, i cili fokusohet në identifikimin, matjen, parandalimin dhe eliminimin e hershëm të shkallës së rreziqeve kryesore që kërcënojnë performancën e tregut. Është bërë progres në lidhje me mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve, pa lënë në harresë pensionet private dhe letrat me vlerë. Megjithatë është i nevojshëm përmirësimi dhe zhvillimi i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit për ngritjen e një platforme raportimi dhe mbikëqyrjeje të tregjeve të sigurimeve dhe të pensioneve private. Është ngritur gjithashtu Grupi Këshillimor i Stabilitetit Financiar i cili synon koordinimin e të gjitha aktiviteteve në këtë fushë.

- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka filluar të ofrojë për kompanitë e mëdha shërbimin për deklarimin dhe kryerjen e pagesave "on-line". Sipas një vërtetimi të kryer nga IDRA mbi biznesin e madh rezultoi se 24% e biznesve jashtë Tiranës dhe 9% të biznesve në Tiranë, kanë si burim

kryesor të informacionit faqen e internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Ndërkohë përqindja e bizneseve që shkarkojnë formularët e deklarimit nga faqja e internetit është 4% gjë që lidhet me besimin ende të ulët.

- Në sistemin doganor përmes sistemit "ASYCUDA++ (sistem automatik i përpunimit të të dhënave gjatë procesit të zhdoganimit) është bërë i mundur përpunimi në kohë reale i deklaratave doganore, zhdoganimi më i shpejtë i ngarkesave, si dhe është përmirësuar kontrolli mbi të ardhurat duke siguruar dhe një informacion më të saktë dhe të azhurnuar për tregtinë e mallrave. Projekti është financuar nga Komisioni Europian, nëpërmjet Programit CARDS. Tashme ky Sistem është implementuar në 17 degë doganore dhe 2 pika doganore, dhe nga këto në 12 degë doganore dhe në 2 pikat doganore komunikimi është online me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave ndërsa në 5 degë doganore komunikimi realizohet përmes e-mail. Aktualisht në sistem përpunohen 99 % të transaksioneve në shkallë vendi. Avantazhet e sistemit qëndrojnë në përpunimin automatik të deklaratave doganore, që nga momenti i regjistrimit dhe deri te pagesa, kryerjen unike të procedurave doganore në të gjitha degët doganore, lidhjen e degëve doganore me qendrën, mbylljen elektronike të tranziteve, përpunimin e një numri shumë të madh të dhënash dhe prodhimin e raporteve me të gjera statistikore, kryerjen e automatizuar të analizës së riskut dhe shumë funksione të tjera.

- Në sektorin e shëndetësisë (e-health). Ka filluar puna për krijimin e një sistemi informacioni për Menaxhimin e Paketës Statistike Shëndetësore, nga Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me ISKSH. Gjithashtu puna ka filluar edhe për shtrirjen e Sistemit të Menaxhimit të Aktivitetit Shëndetësor në Shërbimin Parësor me fonde të parashikuara në buxhetin e vitit 2008. Po kështu me mbështetjen e Bankës Botërore janë parashikuar disa projekte si krijimi i një sistemi të integruar informacioni kombëtar për shëndetin. Pavarësisht këtyre përpjekjeve në drejtim të ofrimit të shërbimit shëndetësor përmes rrugëve elektronike apo e-shëndetësia (e-health) mbetet shumë për të bërë.

- Në sektorin e kulturës (e-kulturë). Sipas përcaktimeve në planin buxhetor afatmesëm, nga Ministria e Turizmit është planifikuar instalimi i rrjetit të internetit në të gjitha institucionet e varësisë dhe trajnimi i personelit për të përmirësuar shërbimet dhe shkëmbimin e informacionit. Synohet të bëhet katalogimi informatik i pasur-



ive kulturore të luajtshme dhe të paluajtshme, në pronësi shtetërore dhe private; lidhja në rrjet e institucioneve të menaxhimit të trashëgimisë mes tyre, si dhe me pikat doganore me qëllim shfrytëzimin e informacionit nga studiuesit dhe kontrollin e lëvizjes së pasurive kulturore të paluajtshme; dalja në internet e një pjese të bazës së të dhënave të pasurive të kataloguara, me qëllim shfrytëzimin e tyre nga publiku.

- Në sektorin e punësimit, me anë të një projekti të financuar nga Qeveria suedeze është bërë e mundur ngritja e një sistemi të teknologjisë së informacionit për punësimin në rajonin e Tiranës dhe Korçës. Me anë të këtij sistemi bëhet e mundur ofrimi i shërbimit të punësimit për punëdhënësit përmes publikimit të ofertave të punës dhe për punëkërkuessit duke ju dhënë më

shumë mundësi kërkimi për vende të lira pune.

Zhvillimet e deritanishme në drejtim të ofrimit të shërbimeve publike elektronike (e-services) tregojnë që jemi ende në fazat e fillimit në rrugën për krijimin e një shoqërie të informacionit. Ende nuk ka një zhvillim në ofrimin e shërbimeve publike elektronike për shëndetin, bujqësinë, sektorin e punësimit, kulturës etj. Mundësimi i këtyre shërbimeve përmes rrugëve të komunikimit elektronik është i rëndësishëm për të realizuar një qeverisje më të mirë, efiçente dhe transparente, të hapur për bashkëpunim me qytetarët dhe komunitetin e biznesit, dhe që do të inkurajojë prosperitetin ekonomik dhe social në tre drejtime kryesore: Qeveri – Qytetare (G2C); Qeveri – Biznes (G2B) dhe Qeveri – Qeveri (G2G).

## 3. EDUKIMI DHE NJOHURITË

### 3.1 E-EDUKIMI

Në Shqipëri ka rreth 465,000 nxënës të arsimit fillor dhe 65,000 nxënës të arsimit të mesëm. Ka rreth 2,900 shkolla fillore dhe rreth 522 shkolla të mesme. Kjo do të thotë se ka mesatarisht më pak se një shkollë fillore për fshat dhe më shumë se një shkollë të mesme për komunë.

Në zbatim të master planit për zhvillimin e TIK në Arsimin parauniversitar, aktualisht janë 732 kabinete informatike në gjëndje pune, nga të cilat 353 janë ngritur vetëm në vitin 2008. Në 37 shkolla të mesme ka nga 2 kabinete informatike; 18 shkolla përdorin shërbimin e internetit të cilin e kanë siguruar në mënyrë të pavarur. Situata paraqitet me një kompjuter për 45 nxënës. Projekt tjetër i rëndësishëm i cili ka përfunduar në vitin 2007, është “Dixhitalizimi i amzës në arsimin e mesëm”, që bëri të mundur krijimin e një baze të dhenash me të dhënat e të tërë nxënësve të këtij arsimit. Eshte në proces dhe deri në fund të vitit 2009, mendohet të përfundojë “Dixhitalizimi i amzës për arsimin bazë”. Është realizuar blerja e 2000 projektorësh dixhitalë

dhe 2000 laptop që do të përdoren në shkolla të mesme, duke krijuar kabinete të lëvizshme që do të përdoren për mësimdhënie edhe në lëndë të tjera. Aktualisht të gjithë Institucionet e Arsimit të Lartë Publik kanë rrjetin e tyre informatik të brëndshëm si edhe shërbim interneti që është siguruar në mënyrë të pavarur. Pajisjet informatike në një pjesë të mirë të universiteteve janë në numër mjaft të vogël dhe të vjetra në kohë. Zyra e zhvillimit italian në bashkëpunim me MASH dhe specialistë të kërkimit shkencor do të realizojë një projekt për krijimin e një rrjeti telematik midis universiteteve. Ky rrjet do të shërbejë për shkëmbim informacioni midis tyre në të gjitha fushat si edhe në kërkimin shkencor.

### 3.2 PROJEKTE NË FUSHËN E KËRKIMIT SHKENCOR MBI TIK

Gjatë vitit 2007, Këshilli i Ministrave miratoi statusin e Shqipërisë si anëtare e asociuar e Programit FP7. Aktivitetet e kërkimit në Shqipëri janë shumë të kufizuara, së pari për shkak të mungesës së infrastrukturës dhe për shkak të pamjaftueshmërisë së burimeve financiare. Një numër i konsiderueshëm specialistësh kanë braktisur institutet e kërkimit shkencor dhe shumica e tyre kanë emigruar jashtë. Departamentet e spe-





cializuara të TIK, në veçanti kanë vuajtur në masë nga "migrimi i trurit". Për të njëjtën arsye institucionet publike, hasin vështirësi të mëdha për të gjetur specialistët e nevojshëm për mirëmbajtjen e përditshme të sistemeve të infrastrukturës së TIK. Megjithatë, në kontekstin e proceseve të integritimit Euro-Atlantike, komuniteti akademik është përfshirë në disa projekte të rëndësishme rajonale të financuara nga Komisioni Europian. Këto projekte përfaqësojnë një arritje të zhvillimit europian të kërkimit shkencor në Ballkan dhe në vendet rreth tij. Shembuj konkrete janë projektet SEEREN dhe SEEREN2 për lidhjen e rrjeteve të kërkimit kombëtar në arsim të vendeve të Ballkanit me rrjetin paneuropian të kërkimit në arsim GEANT. Gjithashtu projektet SEE\_GRID dhe SEE\_GRID2, të cilat synojnë transferimin dhe zhvillimin në rajonin e Europës Juglindore të rezultateve të projekteve në teknologjitë GRID, si një komponent i rëndësishëm në hapësirën Europiane të Kërkimit (ERA). Teknologjitë GRID aftësojnë shfrytëzimin e burimeve në rrjetet pan-europiane të kërkimit në arsim nëpërmjet pjesëmarrjes në organizata kërkimi virtuale europiane. Projekti i financuar nga Qeveria Italiane për krijimin e rrjetit Kombëtar Akademik (kërkim në arsim) në vend, pritet që të jetë me rëndësi të veçantë. Përveç zhvillimit të teknologjive të reja dhe zbatimeve, FP7 parashikon vazhdimin e projektit shumëvjeçar GEANT që realizon lidhjen ndërmjet rrjeteve akademike kombëtare në super rrjetin pan-europian, gjithashtu edhe me rrjete nga komunitete të tjera. Programi aktual kombëtar për kërkimin dhe zhvillimin në TIK gjatë 2007-2009, duke u bazuar në rezultatet e arritura, drejtimet e zhvillimit aktual ndërkombëtar dhe synimet qeveritare, kërkon të inkurajojë zhvillime të reja në TIK dhe përdorimin e tyre.

### 3.3 EDUKIMI I PUBLIKUT DHE BIZNESIT MBI TIK

Progresi i deritanishëm në rritjen e numrit të përdoruesve të internetit, tregon ndër të tjera dhe për një rritje të shkallës së ndërgjegjësimit të publikut për përfitimet dhe mundësitë e ofruara nga TIK.

Po kështu ka një rritje të përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit nga biznesi, në veçanti nga biznesi i madh. Por penetrimi i internetit në vendin tonë mbetet ende i ulët. Një arsye për këtë është edhe shkalla e ulët e njohurive mbi TIK si dhe njohuritë mbi përfitimet që ofron përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Masat e marra për futjen e edukimit për TIK në sistemin arsimor duhet të shoqërohen me plane edukimi për popullatën e gjerë që në një mënyrë ose tjetër do të bëhet përdorues i informacionit apo i shërbimeve elektronike. Një rëndësi të veçantë në drejtim të edukimit mbi përfitimet dhe mundësitë e ofruara nga TIK duhet të tregohet në edukimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NMV), në mënyrë që ato të mund të përfitojnë nga avantazhet teknologjike që sjell përdorimi i TIK. Domosdoshmëria për të treguar një kujdes të veçantë në edukimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, mbështetet në faktin që për Shqipërinë rëndësia e sektorit të NVM-ve, dhe në veçanti e mikro-ndërmarrjeve është e madhe, pasi ato në tërësi punësojnë 77% të totalit të forcës punëtore. Mikrondërmarrjet<sup>9</sup> në Shqipëri zënë pothuajse 95% të totalit të ndërmarrjeve, nga 92% që zenë ato në strukturën e ndërmarrjeve evropiane, duke punësuar 42% të fuqisë punëtore.

**Tabela 1: NVM dhe punësimi në Evropë dhe Shqipëri**

Numri i ndërmarrjeve (në %)	NMV			
	Mikro	Të vogla	Të mesme	Totali
Evropa-19, 2003	92	7	1	
Shqipëria, 2004	95	4	0.8	
<b>Punësimi (në %)</b>				
Evropa-19, 2003	39	17	13	70
Shqipëria, 2004	42	18	18	77

Burimi: Observatori Evropian i NVM-ve dhe INSTAT

<sup>9</sup> Në kuptim të këtij raporti klasifikimi i NVM-ve merr për bazë klasifikimin e rekomanduar nga BE dhe jo atë që parashikon legjislacioni shqiptar për kalsifikimin e NVM-ve. Kështu, mikrondërmarrjet kanë më pak se 10 punonjës, të voglat më pak se 50 punonjës dhe të mesmet më pak se 250 punonjës. <sup>9</sup>Në kuptim të këtij raporti klasifikimi i NVM-ve merr për bazë klasifikimin e rekomanduar nga BE dhe jo atë që parashikon legjislacioni shqiptar për kalsifikimin e NVM-ve. Kështu, mikrondërmarrjet kanë më pak se 10 punonjës, të voglat më pak se 50 punonjës dhe të mesmet më pak se 250 punonjës.a



Ndërsa mikro dhe ndërmarrjet e vogla mundësojnë 59.8% të punësimit, ato arrijnë të kontribuojnë në 63% të volumit të shitjeve dhe duke shtuar këtu edhe kontributin e ndërmarrjeve të mesme, në total NVM-të në Shqipëri kontribuojnë me 79% të volumit të shitjeve, duke qenë në këtë mënyrë baza e sektorit ekonomik jo bujqësor në Shqipëri.

Në kuadrin e projektit ELISA të financuar nga INTERREG IIB CADSES, nga konsorciumi i këtij projekti dhe partnerët shqiptarë Albinvest dhe INIMA është përgatitur një broshurë dhe një platformë elektronike me qëllim dhënien e njohurive bazë për një biznes të suksesshëm në Internet. Ky produkt i projektit është duke u shpërndarë nga Albinvest në kuadrin e planit kombëtar për këshillimin e bizneseve të vogla dhe të mesme.

## 4. E – BIZNESI


Biznesi elektronik ka të bëjë me tregtinë elektronike dhe me një mënyrë të re të operimit të ndërmarrjeve përmes përdorimit aktiv të teknologjive të komunikimit dhe informacionit dhe dixhitalizimit të proceseve të biznesit. Për krijimin e një klime nxitëse për biznesin, Qeveria ka ndërmarrë reformën rregullatore e cila ka dhënë dhe rezultatet e para ndër të cilat përmendim krijimin e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit dhe hartimin e ligjit për nënshkrimin elektronik.

- Regjistrimi i biznesit. Tashmë regjistrimi i biznesit ka kaluar nga kompetencat e gjykatës në ato të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe ka pasur një përmirësim të ndjeshëm në kohën e regjistrimit nga 42 ditë në 1 ditë. Kjo qendër e filloi aktivitetin e saj në shtator të vitit 2007 duke realizuar:
  - Regjistrimin “me një ndalesë” të biznesit;
  - Regjistrimin elektronik;
  - Regjistrin tregtar elektronik;
  - Regjistrimin e mundshëm në të gjithë Shqipërinë (në proces);
- Plotësimin e standardeve ndërkombëtare për regjistrimin e biznesit;
- Përfitimë dhe lehtësira për bizneset.

### TREGTIA ELEKTRONIKE DHE GATISHMËRIA E BIZNESIT.

Për të bërë të mundur realizimin e tregtisë elektronike, është e nevojshme një gatishmëri e lartë e bizneseve. Sipas Indeksit të Gatishmërisë për Rrjet të Raportit për teknologjinë e informacionit të Forumit Ekonomik Botëror, të vitit 2005, Shqipëria ishte në vendin 114 nga 115 vende gjithsej, përsa i përket gatishmërisë së bizneseve për

tregtinë elektronike. Ndërkohe shihet një ndryshim në situatën e përdorimit të internetit nga bizneset në veçanti për biznesin e madh. Ndërmarrjet e mëdha janë duke implementuar zgjidhje software dhe janë duke bërë përpjekje për dixhitalizimin e proceseve të biznesit të tyre në nivelin e ndërmarrjes. Mbështetur në një vërtetim të kryer nga IDRA<sup>10</sup> në rreth 300 kompani të biznesit të madh, rezultojnë se 84% e kompanive të intervistuar kanë akses të plotë në internet në zyrat e tyre, 68% e këtyre bizneseve kanë lidhje me shpejtësi të lartë dhe 58% e bizneseve kanë



intranet në zyrat e tyre.

Kjo është një shifër e konsiderueshme që sugjeron tashmë ekziston infrastruktura për të përdorur shërbime IT. Sidoqoftë duhet të merret parasysh fakti që bëhet fjalë për “tatimpagues të medhenj”, që janë financiarisht dhe administrativisht më të formuar se bizneset e tjera dhe se lidhja me internetin për këto biznese nuk është çështje kostoje. Ndërkohë nuk ka ndonjë vlerësim aktual për përdorimin e internetit nga NVM-të, por sipas raportit të studimit Observatori i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Shqipëri, përgatitur nga

Qendra për kërkim dhe zhvillim, (dhjetor 2006) vërehet se vitet fundit ka një tendencë të NVM-ve për të investuar në modernizimin dhe futjen e teknologjive të reja.

Për të arritur gatishmëri të lartë për tregtinë elektronike ekzistojnë disa kërkesa ligjore të cilat duhen plotësuar të tilla si ligji për tregtinë elektronike, nënshkrimin elektronik, dokumentin elektronik, sigurinë etj. Aktualisht është miratuar ligji Nr. 9880 dt. 25.2.2008, "Për nënshkrimin elektronik", ndërkohë duhet të hartohet ligji për tregtinë elektronike. Sipas angazhimeve në MSA, kuadri ligjor për tregtinë elektronike është planifikuar të përfundojë në mesin e vitit 2009.

Internet Banking në Shqipëri. Kjo praktikë bën të mundur kapërcimin e orareve, eliminimin e pritjes së gjatë në rradhë si dhe aspektet burokratike të bankës tradicionale, duke lejuar administrimin e shpejtë dhe në mënyrë më eficiente të financave personale. Të gjitha bankat në Shqipëri janë të pranishme në internet me faqe të tyre, ku jepen informacione të përgjithshme mbi bankën dhe shërbimet që ajo ofron, por internet banking është ende në fillimet e tij

në Shqipëri. Pjesa më e madhe e produkteve të ofruara nga bankat e nivelit të dytë bëjnë pjesë në paketën tradicionale të shërbimeve: depozita, llogari, transferata.

Edhe pse në tregun shqiptar ekzistojnë banka që kanë mbështetjen e grupeve të fuqishme bankare të huaja, ky shërbim ende nuk është shumë i zhvilluar. Arsyeja kryesore është raporti kosto – përfitim pasi numri i vogël i përdoruesve sjell kosto të lartë dhe humbje për bankat. Nga ana tjetër, nëse nuk ofrohet një shërbim i caktuar është vështirë të përcaktohet numri i përdoruesve potencialë të tij. Duket sikur është një rreth vicioz, megjithatë pika kyçe në këtë rreth mbetet infrastruktura e telekomunikacionit.

Duket se zhvillimi i kësaj infrastrukture ka nxitur disa nga bankat të marrin përsipër sfida për ofrimin e këtyre shërbimeve. Numri i kartave elektronike të pagesave është rritur ndjeshëm, dhe duke u nxitur nga ecuria e këtij përdorimi mund zhvillohet edhe internet banking në të ardhmen. Natyrisht edhe elementët e sigurisë së ofruar nga bankat dhe transparenca mbi koston e tij, janë elementë të rëndësishëm që ndikojnë.

## 5. KUADRI LIGJOR PËR SHOQËRINË E INFORMACIONIT

Zhvillimi i shoqërisë së informacionit kushtëzohet dhe nga përshtatja e legjisllacionit përkatës të nevojshem. Deri tani, janë hartuar dhe miratuar në përputhje me angazhimet e marra në MSA një sërë ligjesh të rëndësishme në fushën e shoqërisë së informacionit:

- Ligji Nr. 9880, datë.25.2.2008 „Për nënshkrimin elektronik“;
- Ligji Nr. 9887, datë. 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale";
- Ligji Nr. 9643, datë. 20.11.2006, i ndryshuar, "Për prokurimet publike", që realizon mundësinë e prokurimit elektronik;
- Ligji Nr. 9723, datë. 3.5. 2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- Ligji Nr. 9918, datë. 19.5.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë";
- Në fushën e krimit kibernetik Shqipëria ka nënshkruar dhe ratifikuar Konventën për Krimin Kibernetik në vitin 2002 dhe ka reflektuar në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale kërkesat e kësaj konvente.

Plotësimi i kuadrit ligjor dhe përmirësimi i tij sipas praktikave më të mira europiane është një nga prioritetet në vijimësi në drejtim të zhvillimit të shoqërisë së informacionit.

## 6. PRIRJET E ZHVILLIMIT TË SEKTORIT TIK NË SHQIPËRI

Megjithëse sipas treguesit të vlerësimit të gatishmërisë elektronike për vitin 2005, Shqipëria renditej ndër vendet e fundit sektori i TIK ka pasur rritje të konsiderueshme. Elementët e ndryshëm që e tregojnë këtë janë:

- Një numër i madh biznesesh që ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e TIK;
- Numri i kompjuterave për 100 banorë është rritur nga 0.5 në vitin 2002<sup>11</sup> në 1.2 në vitin 2005<sup>12</sup>, pra një rritje rreth 2.5 herë, sipas vlerësimeve të INSTAT. Numri i kompjuterave në vend vlerësohet 85.000, ku mbi 50% e tyre përdoren nga bizneset dhe administrata publike.
- Numri i përdoruesve të internetit në Shqipëri vlerësohej rreth 120 408, sipas LSMS 2005, me një rritje të konsiderueshme kundrejt vlerësimeve



të dhëna në dokumentin e Strategjisë Kombëtare të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit të vitit 2003 (në vitin 2000 vlerësohej rreth 2000 përdorues);

Sipas statistikave për teknologjinë e informacionit të publikuara nga ITU<sup>13</sup>, numri i përdoruesve të Internetit në Shqipëri në fund të vitit 2006, vlerësohet në 471200 dhe penetrimi i Internetit 14.98%, shifër kjo që tregon për një rritje të ndjeshme të përdoruesve të internetit.


- Sipas disa të dhënave jo zyrtare nga disa Internet Service Provider, treguesi i rritjes për numrin e përdoruesve të Internetit në vitet e fundit vlerësohet në masën 30%-40%. Pavarësisht nga ky tregues, klientët më të mëdhenj dhe përdoruesit kryesorë të internetit mbeten institucionet shtetërore dhe kompanitë e mëdha të biznesit;

- Numri i domaineve të regjistruara ka gjithashtu një tendencë rritjeje nga viti në vit. Numri total i domaineve aktive të regjistruara deri në fund të

vitit 2007 është 729<sup>14</sup>;

- Tendencat e rritjes në sektorin e TIK jepen dhe në vlerësimin e bëre në kuadrin e projektit: Score-project.eu ku thuhet se " Shumica e produkteve importohen nga jashtë. Gjithsesi, ka një tendencë të fortë dhe në rritje në sektorin e TIK për të përshtatur produktet për nevojat lokale. Disa programe janë përshtatur në gjuhën vendase. Ka një shumëllojshmëri zgjedhjesh në lidhje me pajisjet dhe programet, në të cilat kanë akses dhe mund të përballohen nga shumica e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, sikundër edhe nga shumë individë.

- Të ardhurat nga sektori i teknologjisë së informacionit për vitin 2006 sipas studimit të bërë nga kompania IDC shkojnë deri në 40 milion dollarë<sup>15</sup>; Tendencat e zhvillimit të tregut të IT sipas studimit të IDC jepet në grafikun e mëposhtëm. Në vitin 2007 ky treg pati një rritje 28.3% kundrejt vitit 2006<sup>16</sup>;



<sup>11</sup> INSTAT, LSMS 2002

<sup>12</sup> INSTAT, LSMS 2005

<sup>13</sup> Bashkimi Ndërkombëtar për Telekomunikacionet

<sup>14</sup> Burimi ERT

<sup>15</sup> IDC: IT Market Analyses Study


<sup>16</sup> IDC: Albania IT Market 2008-2012 Forecast and 2007 Vendor Shares




Sipas raportit të studimit Observatori i Ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Shqipëri e përgatitur nga Qendra për Kërkim dhe Zhvillim (dhjetor 2006) vërehet se në dy vitet e fundit ka një tendencë të NVM-ve për të investuar në modernizimin dhe futjen e teknologjive të reja; Mbështetur në vërtetimin e kryer nga IDRA për biznesin e madh, të publikuar në fund të vitit 2007, rezulton se biznesi i madh ka një gatishmëri të lartë për shërbimet IT, të tatimeve, prokurimit

publik dhe regjistrimit të biznesit lidhur me çështjet e përdorimit të internetit ose gatishmërisë për qeverisjen elektronike.

Sipas të njëjtit raport, në lidhje me gadishmërinë për marrjen e shërbimeve online 83% e biznesit do të dëshironte marrjen e informacionit për prokurimet nga faqja e internetit e APP dhe 82% do të dëshironin marrjen e informacionit për tati- met nga interneti;



Në grafikun e mëposhtëm jepet gatishmëria e bizneseve për të kryer regjistrimin e biznesit të tyre në rrugë elektronike.



<sup>13</sup> Bashkimi Ndërkombëtar për Telekomunikacionet

<sup>14</sup> Burimi ERT

<sup>15</sup> IDC: IT Market Analyses Study

<sup>16</sup> IDC: IDC's Albania IT Market 2008-2012 Forecast and 2007 Vendor Shares





KAPITULLI

2

# VIZIONI, PËRPARËSITË DHE QËLLIMET STRATEGJIKE

## KJO STRATEGJI PËRCAKTON SI VIZION:

*Progresin e Shqipërisë drejt një ekonomie të bazuar në njohuritë, përmes një zhvillimi të qëndrueshëm të shoqërisë së informacionit që do të çojë në një shoqëri ku të gjithë qytetarët përfitojnë nga teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit me qëllim shtimin e njohurive, rritjen e efektshmërisë dhe të transparencës në administratën publike.*

Qëllimet strategjike që do të ndiqen për përbushjen e këtij vizioni janë:

- Përmirësimi i infrastrukturës së teknologjise së informacionit dhe komunikimit
- Synohet që deri në vitin 2013 **administrata qëndrore dhe vendore** në të gjithë Shqipërinë, si dhe qytetarët dhe bizneset të kenë mundësi përdorimi të shërbimeve të rrjetit të shpejtësisë së lartë. Si objektivi afatmesëm synohet që të realizohet lidhja broadband e të gjithë administratës publike deri në fund të vitit 2010.
- Për të lehtësuar ofrimin e shërbimit të lidhjes në rrjet me shpejtësisë të lartë, **do të garantohet dhe do të nxitet konkurrenca** midis operatorëve për mundësuari çmime të arsyeshme dhe të krahasueshme me vendet e rajonit.
- Synohet **krijimi i mundësisë për internet të lirë**, të shpejtë dhe të sigurtë nëpërmjet:
  - garantimit të aksesit të shpejtë dhe me më pak kosto në internet për të gjithë qytetarët në pikat publike të aksesit, të preferuara me lidhje broadband, në komuna dhe bashki;
  - ofrimin të internetit të shpejtë për studentët dhe kërkimin shkencor;
  - rrjete të sigurta dhe karta inteligjente « smart » për zhvillimin e tregtisë elektronike;

- bashkëpunimit me sektorin privat për ngritjen e pikave të aksesit në internet (dhe do të shfrytëzojë skemat e financimit si Ndhima Shtetërore apo fondi për shërbimin universal.

- Deri në fund të vitit 2010 synohet që penetrimi i internetit me shpejtësi të lartë të arrijë në nivelin 50% të nivelit mesatar të penetrimit të internetit me shpejtësi të lartë në vendet e BE<sup>17</sup>;
- Synohet ngritja e **Qendrës Kombetare për Shkëmbimin e Internetit (IXP)**.

## ZHVILLIMI I QEVERISJES ELEKTRONIKE

- Synohet kalimi nga faza e parë e shpërndarjes së informacionit në rrugë elektronike në atë të **ofrimin të shërbimeve elektronike dhe interaktive**;
- Qeverisja elektronike do të shtrihet në nivelin qendror dhe atë lokal nëpërmjet **portaleve të të gjitha institucioneve**, gjë që do të sigurojë akses elektronik në shërbimet publike për të gjithë ;
- Deri në fund të vitit 2013 shërbimet publike bazë do të ofrohen në mënyrë **interaktive, të thjeshtë dhe të aksesueshme** për të gjithë. Për këtë është i nevojshëm shfrytëzimi i rrjeteve broadband dhe aksesit në platforma të ndryshme. Lista e këtyre shërbimeve do të përcaktohet në përputhje me praktikat më të mira europiane.



- o Synohet **standartizimi** i paraqitjes së institucioneve publike në internet;
- o Shërbimet publike që ofrohen *online* do të shoqërohen me përshkrimin e tyre dhe dokumentet e nevojshme për të përfituar prej tyre do të jenë të disponueshëm dhe do të mund të shkarkohen nga interneti;
- o Do të krijohet një ambient i sigurt komunikimi midis shërbimeve publike dhe për shkëmbimin e informacionit të klasifikuar qeveritar.

## SHËRBIMET PUBLIKE

- o **Prokurimi elektronik.** Synohet që deri në vitin 2013 të gjitha prokurimet publike do të bëhen në mënyrë elektronike sipas rregullave dhe përvojës më të mirë ndërkombëtare dhe normave evropiane.
- o **Financat publike**
- o **Transferimi i fondeve** në të gjitha qendrat urbane si dhe në komuna do të bëhet në mënyrë elektronike.
- o Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve do të fuqizohet dhe zhvillohet më tej ofrimi i shërbimeve elektronike në sektorin e tatimeve;
- o **Sistemi doganor** do të kryejë 100% transaksionet në rrugë elektronike;
- o **Në fushën e-shëndetësisë** do të synohet promovimi i cilësisë dhe efikasitetit në kujdesin shëndetësor përmes aplikimeve të shëndetit elektronik.

## EDUKIMI DHE PËRHAPJA E NJOHURIVE

- o Do të investohet në burimet **njerëzore dhe në aftësitë për të pasur një** rini në botën dixhitale;
- o Do të synohet që deri në fund të vitit 2013 **të gjitha shkollat e vendit të kenë kabinetet informatike** dhe akses në internet me shpejtësi të lartë; Deri në fund të vitit 2010, synohet të arrihet në raportin 1 kompjuter për 25 nxënës.
- o Do të bëhet **pjesë e programeve mësimore** për shkollat fillore, lënda njohuri mbi teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit si dhe do të përmirësohen programet mësimore të TIK për shkollat e mesme, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian. Do të realizohen trajnime për të gjithë mësuesit e lëndës së informatikës dhe administratorët e shkollave për mësimin e TIK.
- o **Universitetet dhe qendrat kërkimore shkencore** do të jenë të lidhura me rrjetin Geant dhe të gjitha universitetet e Tiranës do të përdorin në mënyrë të përbashkët një rrjet me fibër të shpejtësisë së lartë i cili do t'i lidhë të gjitha

fakultetet. Qeveria do të angazhohet për pranimin e studentëve për kryerjen e praktikave mësimore pranë administratës publike;

## NXITJA E PËRDORIMIT TË TEKNOLOGJIVE TË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT NGA BIZNESI

- o Do të stimulohet përdorimi i internetit përmes krijimit të kuadrit të nevojshëm ligjor për biznesin elektronik dhe edukimit të biznesit për përfitimet dhe mundësitë e ofruara nga teknologjia e informacionit dhe komunikimit. Teknologjitë e informacionit dhe komunikimit lejojnë forma të reja të partneritetit ndërmjet kompanive ofruesve dhe konsumatorëve duke përmirësuar mënyrën e punës, produktet dhe shërbimet që ata ofrojnë. Kjo kërkon teknologji të reja dhe njëkohësisht aftësitë e duhura. Krijimi dhe forcimi i rrjetit mbështetës për biznesin elektronik me qëllim forcimin dhe koordinimin e veprimeve mbështetëse për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Rritja e njohurive të biznesit të vogël dhe të mesëm mbi përfitimet e fituara përmes implementimit të zgjidhjeve të avancuara e-biznes.
- o Krijimi i kuadrit rregullator për të nxitur **tregtinë elektronike** do të jetë një mundësi për NVM në Shqipëri.
- o Synohet që deri në vitin 2013, Shqipëria të jetë në nivelet e mesme në renditjen e **Indeksit të Gatishmërisë për Rrjet** dhe të treguesve të tjerë të gatishmërisë për ekonominë informatike.

## PËRMIRËSIMI I LEGJISLACIONIT PËR

Në përputhje me angazhimet e marra në MSA do të punohet për plotësimin dhe përmirësimin e legjislacionit përkatës për shoqërinë e informacionit.

Një rëndësi e veçantë do t'i kushtohet implementimit të legjislacionit për krijimin e një ambienti të sigurtë dhe konfidencial.

## SHOQËRINË E INFORMACIONIT.

Vizioni i qeverisë për krijimin e një shoqërie të informacionit është i inkuadruar plotësisht edhe në një vizion më të gjerë, për **zhvillimin e shoqërisë së informacionit në rajon**. Shqipëria është pjesë e **iniciativës rajonale e-SEE**, të Paktit të Stabilitetit<sup>18</sup> dhe aktivitetet si dhe angazhimet e marra në kuadër të kësaj iniciative do t'i shërbejnë edhe zhvillimeve në Shqipëri.





Ministrat përgjegjës për zhvillimin e Shoqërisë së Informacionit apo përfaqësuesit e tyre nga Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Serbia, Maqedonia dhe Moldavia, duke njohur suksesin e e-Evropës, iniciuar nga udhëheqësit e BE-së në Lisbonë në Maj 2000 dhe e-Europe+, iniciuar nga udhëheqësit e vendeve candidate në Gotenberg në Qershor 2001, kanë adaptuar një Deklarate të përbashkët në Lubjane në Qershor 2002 dhe kanë firmosur një Axhendë eSEEuropë për Zhvillimin e Shoqërisë së Informacionit në Tetor 2002 Beograd, si dhe një Deklarate të Përbashkët më 26 Shkurt 2004 në Budapest. Gjithashtu kanë nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi mbi zhvillimin e një tregu plotësisht të interkonektuar për shërbimet me brez të gjerë në rrjetet e Evropës dhe global, iniciativa për zhvillimin e rrjeteve me brez të gjerë "bSEE", Selanik 2005, si dhe së fundmi në mbledhjen e zhvilluar në Sarajevë kanë firmosur eSEE Agenda Plus, në 28-29 Tetor 2007.

#### DOKUMENTI e-SEE AGENDA+ PËRMBAN KËTO PRIORITETE:

- **Krijimi i një hapësire të vetme informacioni për Evropën Juglindore** që nënkupton


zhvillimin e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit, përdorimin e rrjeteve broadband të shpejtësisë së lartë të komunikimit, adoptimin e rrjeteve kombëtare të ndërveprueshme me ato evropiane për të siguruar përshtatshmëri dhe kooperim të sistemeve.

- **Nxitja e novacioneve dhe investimeve** në kërkim dhe edukim që përfshin kompjuterizimin dhe aksesin e internetit në shkolla, futjen e kurikulave për aftësi në TIK, krijimin e qendrave të trajnimit për TIK etj.

- **Shoqëria e Informacionit gjithëpërfshirëse**, duke garantuar aksesin për të gjithë dhe mundësi të barabarta ofrimi.

Zbatimi i eAgenda Plus do të shoqërohet me një platforme të ofruar nga grupi i punës i iniciativës eSEE. Në procesin e implementimit të eSEE Agenda+, vendet pjesëmarrëse do të ndërmarin aksione bashkëpunimi dhe do të ndërtojnë një partneritet të fortë me vendet e BE. Të gjitha reformat do të implementohen në përputhje me kuadrin e harmonizimit me Acquis Communitaires në respekt të të gjithë angazhimeve përkatëse dhe detyrimeve për t'u anëtarësuar në BE.





KAPITULLI

3

# POLITIKAT QË DO TË NDIQEN

Në këtë kapitull paraqiten politikat që do të ndiqen për përmbushjen e vizionit dhe qëllimeve strategjike të këtij dokumenti. Këto politika koordinohen nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe janë në përputhje me SKZHI, angazhimet e marra në MSA dhe me iniciativat **eSEE** dhe **bSEE** të Paktit të Stabilitetit.

Strategjia Ndërsektoriale për Shoqërinë e Informacionit bazohet në realitetin dhe nevojat e zhvillimit në nivel kombëtar si dhe burimet dhe mundësitë që ofrohen për ndërtimin e shoqërisë së informacionit. Politikat e parashikuara në të, në harmoni me politikat e tjera sektoriale dhe ndërsektoriale të miratuara nga Qeveria shqiptare, do të synojnë sigurimin e një ambienti të favorshëm për investime private dhe krijimin e vendeve të reja të punës për të rritur produktivitetin, modernizimin e shërbimeve publike dhe për t'i dhënë të gjithëve mundësinë për të qenë pjesë e shoqërisë globale të informacionit.

## 3.1 ZHVILLIMI I INFRASTRUKTURËS SË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Infrastruktura e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit përbën një faktor kyç për formimin/ndërtimin dhe zhvillimin e shoqërisë së informacionit. Politikat në fushën e infrastrukturës do të synojnë nxitjen e zhvillimit të infrastrukturës së TIK në mënyrë që ajo të bëhet e disponueshme në kushte të barabarta, jo diskriminuese dhe me çmime të përballueshme, në mënyrë që të gjithë qytetarët të përfitojnë nga teknologjitë e infor-

macionit dhe të komunikimit me qëllim shtimin e njohurive, rritjen e efektshmërisë dhe të transparencës në administratën publike.

Ligji Nr. 9918, datë. 19.5.2008, i komunikimeve elektronike, i hartuar në përputhje me acquis communautaire (paketa e direktivave të vitit 2002), përbën një hap të rëndësishëm në kuadër të iniciativave të qeverisë për liberalizimin e plotë të tregut të telekomunikacioneve. Ai shënon dhe një moment të rëndësishëm për heqjen e barrierave hyrëse në treg përmes kalimit nga regjimi i licensave individuale në atë të autorizimit të përgjithshëm. Ky ligj garanton të drejtën e sipërmarrësve për ofrimin e shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike. Një parim bazë në këtë ligj është ai i neutralitetit teknologjik. Rrjetet e komunikimeve elektronike që kërkojnë përdorimin e burimeve të kufizuara si frekuencat, pajisen me të drejtën e përdorimit të tyre dhe numri i të drejtave të përdorimit kufizohet vetëm në rastet kur mundësitë e dhënies në përdorim janë të kufizuara.

Zbatimi i këtij ligji, kërkon hartimin e një kuadri rregullator efektiv si dhe plotësimin me një sërë aktesh nënligjore. Plotësimi dhe përmirësimi i kuadrit ligjor e rregullator do të krijojnë mundësi për ofrimin e shërbimeve të reja të favorizuara nga progresi teknologjik dhe konvergjenca teknologjike dhe nxitjes së konkurrencës në treg.

Në këtë drejtim është e rëndësishme të realizohen nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare:

- Hartimi i një politike për zhvillimin e shërbimeve me brez të gjerë/broadband;
- Dhënia për përdorim apo licensimi i



frekuencave të teknologjisë wireless (WIMAX; 3G;)

- Krijimi i një kuadri ligjor e rregullator të qartë dhe efektiv në përputhje me direktivat e Bashkimit Europian dhe praktikat më të mira;

Po kështu është i domosdoshëm forcimi i kapaciteteve dhe i rolit të Drejtorisë së Politikave të Postë Telekomunikacionit në Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, si dhe të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare si organ rregullator.

Akualisht, në Ministrinë e Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit po punohet për hartimin e Dokumentit të Politikave<sup>19</sup> të Zhvillimit të Sektorit të Komunikimeve Elektronike i cili, në mënyrë të veçantë do të përcaktojë objektivat afatmesëm dhe afatgjatë të zhvillimit të këtij sektori, do të adresojë problemet e lidhura me shërbimin universal dhe krijimin e pikave të aksesit për publikun, interkoneksionin, menaxhimin e frekuencave, mbrojtjen e konsumatorit, numeracionin, përdorimin e përbashkët të pajisjeve, dhe ULL etj.

Ky dokument do t'i shërbeje vlerësimit cilësor dhe sasior të infrastrukturës i cili, gjithashtu, kërkon kooperimin përmes enteve publike, organizatave, kompanive private, dhe autoriteteve profesionale dhe lokale.

Drejtimet e politikës në fushën e infrastrukturës që do të ndërmarrë Ministria e Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit do të synojnë inkurajimin e bashkëpërdorimit të infrastrukturës nga operatorët për të siguruar përdorimin efektiv të burimeve dhe për të reduktuar koston e instalimit të infrastrukturës së re.

## MENAXHIMI I SPEKTRIT

Spektri i radiofrekuencave është një burim i kufizuar natyror dhe i një rëndësie të veçantë për infrastrukturën e komunikimit dhe informimit ku një pjesë të rëndësishme zënë dhe komunikimet pa tela. Dinamika e zhvillimit të teknologjive me brez të gjerë pa tela, dhe avantazhet që ato mbartin në përmbushjen e objektivave të një Shoqërie Informacioni, ka rritur rëndësinë e përzgjedhjes së mekanizmave për një menaxhim sa më efektiv të spektrit të radiofrekuencave, konform standarteve europiane dhe ndërkombëtare. Autoritetet përgjegjëse për dhënien në përdorim të frekuencave do të udhëhiqen nga parimi i neutralitetit teknologjik. Procesi i dhënies

në përdorim të frekuencave do të kryhet përmes procedurave të hapura që sigurojnë transparencë, mosdiskriminim dhe përdorimin eficient të tyre.

## NDËROPERIMI

Ndëroperimi i shërbimeve dhe adoptimi i standarteve nga ofruesit e shërbimeve, si në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, maksimizon mundësitë e rrjeteve.

Principi bazë që udhëheq zhvillimin e infrastrukturës së komunikimeve kombëtare duhet të jetë akses i lirë në rrjete dhe informacion dhe promovimi dhe mbrojtja e konkurrencës.

## SIGURIMI I SHËRBIMIT UNIVERSAL

Shërbimi universal ka një rol të dyfishtë: social dhe zhvillues. Përmbajtja e shërbimit universal duhet të ndryshojë dinamikisht për të qënë në linjë me zhvillimet e vazhdueshme të infrastrukturës, teknologjive dhe kërkesave të përdoruesve. Shërbimi universal duhet të përfshijë ato elemente që i shërbejnë eliminimit të diskriminimeve për aksesin nga të gjithë në Shoqërinë e Informacionit.

## SIGURIMI I SHËRBIMEVE ME BREZ TË GJERË DHE MUNDËSIA E AKSESIT KUDO DHE NË ÇDO KOHË

Mjedise të favorshme duhet të krijohen për shfrytëzimin e teknologjive të reja. Kombinimi i tregut të liberalizuar me konvergjencën e teknologjive u jep përdoruesve mundësinë të përzgjedhin si shërbimet e preferuara dhe pagesat e tyre ashtu dhe ofruesit e shërbimit.

Tendencat e Zhvillimit të Infrastrukturës janë:

- Dominanca e plotë e teknologjive dixhitale
- Pozicioni dominant i standarteve Europiane
- Zhvillimi dinamik i Internetit me brez të gjere si një mënyrë dominante e transmetimit të informacionit dhe si një rrjet i përbashkët komunikimi në shoqërinë tonë.
- Njohja e nevojës për sigurinë e rrjeteve nëpërmjet implementimit të teknikave të përshtatshme.
- Zhvillime të konsiderueshme të sistemeve satelitore.



Zbatimi i ligjit të ri të komunikimeve elektronike dhe politika sektoriale do të krijojnë mjedis të favorshëm për investime dhe implementimin e teknologjive më të fundit në të gjitha format e komunikimit. Kjo do të çojë në rritjen e konkurrencës në tregun e komunikimeve elektronike dhe për pasojë do të sjellë përfitime për konsumatorin si, ofrimin e një game të gjerë shërbimesh bashkëkohore, cilësore dhe me çmime të përbalueshme.

**Pikat e Aksesit Publik (PAP):** Hyrje të lirë dhe të besueshme për të gjithë në Internet.

Lidhja me Internetin nga shtëpitë është shumë e rrallë në Shqipëri dhe praktikisht nuk ekziston në zonat rurale. Pikat e informacionit publik duhet të ndërtohen në tërë vendin, dhe në veçanti duhet të mbështetet vendosja e tyre në zonat e largëta.

Përmbajtja dhe aplikimet, ose shërbimet e qeverisjes elektronike duhen të bëhen të mundura nëpërmjet këtyre pikave të aksesit publik. Projekte pilote për PAP në komunat që përdorin teknologjitë me radiovalë mund të shtrijnë më tej numrin e lidhjeve. Për këtë mund të shfrytëzohet infrastruktura e shpërndarë në të gjithë vendin e zyrave postare.

## 3.2 NXITJA E QEVERISJES SË MIRË PËRMES SHËRBIMEVE ONLINE MODERNE

Koncepti i qeverisjes elektronike, rrjedh në kuadër të iniciativës europiane "e-Europe" (Europa elektronike), ç'ka dotë thotë se qeveria do të jetë e para që do të iniciojë procesin në tërësi në mënyrë që të demonstrojë vendosmërinë për implementimin e konceptit të shoqërisë së informacionit. Qeverisja efiçente dhe transparente, e hapur për bashkëpunim me qytetarët, ky është koncepti që do të sigurojë shërbime më të mira për qytetarët dhe komunitetin e biznesit. Zbatimi i këtij koncepti do të inkurajojë prosperitetin ekonomik dhe social në tre drejtime kryesore:

- Qeveri – Biznes;
- Qeveri – Qytetarë;
- Qeveri - Qeveri.

Në mënyrë që të bëhet e mundur që qytetarët

e Republikës së Shqipërisë të jenë faktorë në Shoqërinë e Informacionit do të jetë e nevojshme të zhvillohen politika koherente në mënyrë që të gjithë sektorët të jenë në gjendje të ofrojnë shërbime elektronike:

- Të unifikuara;
- Të standartizuara;
- Të pavarura nga platformat e përdorura dhe teknologjitë ;
- Të thjeshta në përdorim;

Në rolin e qeverisë si promotore në zhvillimin e shoqërisë së informacionit, për të siguruar një ndjekje më të mirë të zhvillimit të politikave për shoqërinë e informacionit është krijuar grupi ndërinstytucional nën drejtimin e Zëvendëskryeminitrit (sipas Aneksit 1);


Qeveria është angazhuar për zhvillimin e politikave që :

- Garantojnë dhe sigurojnë demokracinë në Republikën e Shqipërisë;
- Mbështesin zhvillimin e infrastrukturës së informimit;
- Mbështesin krijimin e një ekonomie dinamike përmes rritjes së konkurrencës, përsheptimit të kthimit të pronave, zhvillimit të tregëtisë elektronike dhe informatizimit të sistemit bankar;
- Mbështesin zhvillimin e kulturës dhe turizmit.
- Mbështesin përmirësimin e mbrojtjes shtetërore si rezultat i zhvillimit të teknologjisë së informacionit.

Synimi i të gjitha veprimeve të ndërmarra dhe që do të ndërmerren në zbatim të SK-ZHI dhe kësaj strategjie do të jetë shndërrimi i hendeikut dixhital në mundësi dixhitale për zhvillim dhe transformim.

Qeverisja elektronike premtun një shpërndarje më të mirë dhe më efiçente për shërbimet publike dhe përmirëson marrëdhënien midis qytetarëve dhe qeverisë. Megjithatë shfrytëzimi i teknologjive të informacionit në shërbimet qeveritare, nuk nënkupton kalimin e menjëhershëm (automatik) në qeverisjen elektronike, pasi implementimi i teknologjive të informacionit dhe komunikimit bëhet paralelisht me ndryshimet organizative dhe përshtatjen e aftësive dhe kualifikimeve. Në grafikun më poshtë tregohen fazat nëpër të cilat kalon procesi i qeverisjes elektronike.





NJE PROCES I GJATE DHE KOMPLEKS

Nëse qeverisja elektronike implementohet në mënyrë korrekte, ajo mundëson shumë më tepër se përfitimet e thjeshta të realizuara nga reduktimi i radhëve:

- o Reduktimin e kostove për biznesin dhe qeverinë, reduktimin e detyrimeve të taksave dhe nxitjen e konkurrencës.
- o Sektori publik bëhet më transparent dhe i hapur, forcohet demokracia, rritet përgjegjshmëria ndaj qytetarëve si dhe pjesëmarrja e qytetarëve në procesin e politikbërjes, administrata orientohet duke vënë në qendër qytetarin dhe sigurohen shërbime online 24 orë ditë, 7 ditë të javës, pavarësisht rrethanave dhe nevojave të veçanta.

Drejtimet strategjike që do të ndiqen për sa i përket ofrimit të shërbimeve publike, janë:

1. Shfrytëzimi i **rrejtit kompjuterik ndërministror (GovNet)** për ofrimin e një vargu shërbimesh jo vetëm për qeverinë, por edhe për qytetarët. Gjatë vitit 2008 do të fillojnë punimet për fazën e dytë të këtij projekti. GovNet 2, do të krijojë një rrjet qeveritar homogjen, dhe të sigurtë duke sjellë dhe përfitime të tjera të tilla si reduktimi i kostove të komunikimit qeveritar si dhe një komunikim më të mirë .

2. Ndërtimi i sistemit të sigurisë fizike dhe logjike të GovNet për të cilin po punohet intensivisht. Ky sistem do të mundësojë operimin e sistemeve të mëposhtme:

- Mbledhjet e Qeverisë online (e-Kabinet);
- Sisteme IMS (Information Management System) për sektorë të ndryshëm të aktivitetit të Qeverisë;
- Sistemet e administrimit të dokumentacionit dhe të arkivave;
- Sistemi dhe Baza e të Dhënave të HRMS (Departamenti i Administratës Publike);
- Implementimi i plotë i Sistemit të The-sarit (Ministria e Financave);
- Implementimet e mëtejshme në: e-business (QKR), e-taksë (DPTT), e-prokurimi (APP);
- e-Shërbime të reja nëpërmjet portaleve qeveritare (e-Albania);
- Sistemi i dëshmive të penalitetit (Ministria e Drejtësisë);
- Shërbimi i Gjendjes Civile dhe Kartës së Identiteti;

3. Koordinimi i të gjitha nismave me qëllim maksimizimin e përfitimeve, standardizimin, si dhe **ofrimin e shërbimeve 'online' qytetarëve** në një hapësirë informacioni të integruar. Këto shërbime përfshijnë, kartat e identitetit, pasaportat elektronike, regjistrimin e automjeteve, aplikime për përfitimet nga sigurimet shëndetësore, regjistrimin e të papunëve, pagesat për sigurimet shoqërore, evidentimin e pronësisë, aplikimin për leje ndërtimi, deklarimin doganor, transparencën e vendimeve gjyqësore, si dhe përdorimi i firmës dixhitale;

4. Krijimi i bazave të të dhënave elektronike në ministrinë, institucionet e varësisë sipas fushës së veprimtarisë së tyre. Sistemet, bazat e të dhënave që do të krijohen do të shërbejnë për shtimin e shërbimeve publike të ofruara në rrugë elektronike. Në krijimin e këtyre bazave të të dhënave do të synohet respektimi i standarteve të hapura, dhe sigurimi i interoperabilitetit të tyre.

5. Futja në përdorim e kartave të identitetit dhe e pasaportave elektronike do të rrisë nivelin e shërbimit për qytetarët duke e bërë procesin e identifikimit të sigurt, të shpejtë dhe të çertifikuar. Do të krijohet lidhja midis sistemit të gjendjes civile dhe sistemit të kartave të identitetit.

6. Ofrimin e shërbimeve mbi bazat e gjithëpërfshirjes, mosdiskriminimit, transparencës dhe aksesit të barabartë për të gjithë. Një vëmendje e vecantë do të tregohet për krijimin e mundësive të përfitimit dhe nga shtesa të shoqërisë me nevoja të veçanta sociale.

## E-DREJTËSIA

Janë marrë masa për ndërtimin e një Sistemi për Menaxhimin e Dokumentacionit për Ministrinë e Drejtësisë duke bërë studimin dhe nxjerrjen ToR për ndërtimin e tij. Politikat që do të ndiqen në të ardhmen janë:

- Ndërtimi i një rrjeti të brendshëm të dixhitalizuar intraneti mes Ministrisë së Drejtësisë dhe disa prej institucioneve të varësisë,
- Kompjuterizimi i shërbimit të përmbartimit gjyqësor;
- Krijimi i një sistemi regjistrimi (audio, video) dhe kartele mjeko – ligjore për Institutin e Mjekësisë Ligjore,
- Krijimi i një rrjeti të brendshëm të dixhitalizuar intraneti për të gjithë sistemin e Shërbimit Përmbartimor, Sistemin e Gjykatave, Avokaturës së Shtetit dhe Burgjeve.
- Instalimi i rrjetit kompjuterik për funksionimin e administratës së burgjeve në vitin 2009, si një nga objektivat e vendosura në Planin Buxhetor Afatmesëm.

Po punohet për zbatimin e sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve dhe përmirësimin e sistemit të teknologjisë së informacionit në gjyqësor, ndërtimin e një sistemi VOIP mes Gjykatave si dhe forcimin e bashkëpunimit ndërkufitar për një menaxhim të integruar të informacionit në luftën kundër krimit të organizuar; Është në proces sistemi i kadastrës elektronike,

certifikatës së pronësisë si dhe regjistrimi hipotekor i pengut për personat ligjor;

## E-TAKSË

Lufta kundër krimit ekonomik, evazionit fiskal dhe korrupsionit, si sfidat më prioritare të qeverisë, janë edhe sfidat më evidente, me të cilat po përballet çdo ditë administrata tatimore. Është dhënë prioritet kontrollit të brendshëm, në funksion të luftës ndaj evazionit fiskal. Synohet që në planin afatmesëm të gjithë pagesat me vetëdeklarim të kryhen "on-line" duke iu shmangur burokracive administrative dhe duke reduktuar ndjeshëm kohën e biznesit.

## E-DOGANA

Në administratën doganore do të zbatohet sistemi automatik i përpunimit të të dhënave ASYCUDA++ si dhe do të mundësohet migrimi në sistemin ASYCUDA WORLD.

Gjatë vitit 2008 – 2009 synohet përpunimi 100% i deklaratave doganore përmes sistemit automatik të përpunimit të të dhënave, si dhe migrimi i ASYCUDA ++ në ASYCUDA WORLD.

## PUNËSIMI

Në planifikimin afatmesëm synohet hartimi i një regjistri kombëtar të subjekteve dhe të punësuarve, ofrimi i informacionit online për punësimin.

Në vijim të projektit pilot të financuar nga qeveria suedeze për ngritjen e Sistemit Informatik të Punësimit në rajonet e Tiranës dhe Korçës, do të punohet që ky sistem të shtrihet shumë shpejt edhe në Zyrat e tjera Rajonale të Punësimit në të gjithë vendin.

Sistemi kryesor i IT-së - ai i shërbimeve të punësimit, do të përmbajë:

- Banka e vendeve të lira të punës;
- Banka e punëkërkuësve të papunë;
- Banka ose regjistri i biznesit.

## SIGURIMET SHOQËRORE

Objektivat dhe prioritetet e Insitutit të Sigurimeve Shoqërore, janë mirëadministrimi i sistemit, reformimin e tij, pastrimi i skemës nga përfituesit e padrejtë në kuadër të luftës kundër informalitetit, rritja e performancës së institucionit, rritja e cilësisë së shërbimeve ndaj klienteve etj. Arritja e këtyre objektivave, suksesi i tyre janë ngushtësisht të lidhura me informatizimin e sistemit me automatizimin e proceseve



të punës.

Në periudhën afatmesme në fushën e sigurimeve shoqërore për realizimin e këtyre objektivave janë parashikuar këto projekte:

1. Ngritja e një sistemi informacioni modern që konsiston në informatizimin e llogaritjes së përfitimeve, mbledhjes së kontributeve dhe të sistemit të pagesave. Ky projekt do të bëjë të mundur rritjen e cilësisë së punës, saktësisë së llogaritjes dhe uniformitetin e zbatimit të ligjit, krijimin e një historiku karriere për çdo kontribues, të saktë dhe transparent, dhe mirëadministrimin e fondëve financiare të ISSH. Pra, e ndarë në komponente paraqitet si më poshtë:

- Informatizimi i të dhënave të kontribuesve, krijimi i bazës së të dhënave
- Krijimi i llogarive personale të kontribuesve
- Informatizimi i bazës së të dhënave të pensioneve
- Llogaritja automatike e pensioneve
- Prodhimi i urdhërpagesave të pensioneve dhe lidhja online me ato pika postare që janë informatizuar dhe shkarkimi automatik i kartelave të pagesës së pensioneve, procesi është i kondicionuar me informatizimin e Postës

2. Ngritja e arshivës së centralizuar të kontributeve dhe të përfitimeve. Ky projekt do të krijojë mundësinë e grumbullimit të të gjitha dokumentave të sigurimeve shoqërore deri tani të shpërndara, në një arkive të centralizuar duke rritur sigurinë fizike, kushtet e ruajtjes, mbrojtjen nga falsifikimet e mundshme dhe uljen e informalitetit.

3. Harmonizimi i procedurave të kontabilitetit dhe "work flow", sistemi financiar i ISSH me Ministrinë e Financave, Thesarin dhe Bankën Qendrore të Republikës së Shqipërisë.

4. Krijimi i rrjeteve të tranzitimit të të dhënave online nga Drejtoria e Përgjithshme e ISSH në 12 drejtoritë rajonale të sigurimeve shoqërore, Agjencitë dhe anasjelltas.

## E-SHËNDETËSIA

Politikat afatgjata të sektorit të shëndetësisë konsistojnë në: hartimin e një kuadri ligjor të plotë dhe modern një sistem financimi adekuat të burimeve njerëzore të afta për t'iu përgjigjur nevojave të sistemit shëndetësor dhe një sistem informacioni të plotë në të gjitha nivelet e shërbimit shëndetësor. Vendosja e pacientit në qendër të

vëmendjes. Akses më i mirë për shërbimin shëndetësor parësor dhe ofrim të shërbimeve sipas normave dhe standarteve të përcaktuara.

Në fushën e shëndetësisë vendi përballlet me një sërë sfidash, por interesi për zhvillimin e telemedicine dhe e-health është i qartë. Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor (ISKSH) në bashkëpunim me Bankën Botërore janë angazhuar për zhvillimin dhe implementimin e një sistemi të integruar informacioni shëndetësor kombëtar (S.I.I.SH.K) si dhe pajisjen me karta elektronike shëndetësore që do të zëvendësojnë formën manuale të të dhënave shëndetësore.

Nisur nga fakti që sistemi aktual i informacionit shëndetësor në Shqipëri vlerësohet i copëzuar, me cilësi të dobët shpesh nuk jepet në kohën e duhur, Ministria e Shëndetësisë e konsideron rishikimin e sistemit të informacionit shëndetësor si një nga përparësitë e saj urgjente. Politikat që do të zbatohen në drejtim të e-health konsistojnë në:

- Projekti për informatizimin e sektorit të arkivë-protokollit;

- Projekti për sistemin e informacionit në shërbimin parësor;

- Sistemi i menaxhimit të paketës statistikore në të gjithë drejtorinë e shëndetit publik në nivel qarku;

- Lidhja online e ministrisë me drejtoritë rajonale;

- Projekti health-net;

- Projekti për regjistrimin e burimeve njerëzore në sektorin shëndetësor;

- Krijimi i një sistemi të integruar informacioni shëndetësor kombëtar;

Krahas këtyre projekteve që janë në proces, nga ministria e shëndetësisë janë planifikuar edhe aktivitetet e mëposhtme:

- Ngritja e sistemit të informacionit për kompjuterizimin e procedurave të licensimit të aktivitetit shëndetësor privat;

- Krijimi i një baze të dhënash për indikatorët e mjedisit dhe shëndetit;
- Administrimi financiar i aktivitetit





shëndetësor;

Aktivitetet e parashikuara nga Ministria e shëndetësisë jepen në tabelën përmbledhëse të Aneksit 3.

## E-KULTURË, E-TURIZMI

Në fushën e e-kulturës dhe e-turizmit synohet të bëhet katalogimi informatik i pasurive kulturore të luajtshme dhe të paluajtshme, në pronësi shtetërore dhe private, lidhja në rrjet e institucioneve të menaxhimit të trashëgimisë mes tyre, si dhe me pikat doganore me qëllim shfrytëzimin e informacionit nga studiuesit dhe kontrollin e lëvizjes së pasurive kulturore të paluajtshme, dalja në internet e një pjese të bazës së të dhënave të pasurive të kataloguara, me qëllim shfrytëzimin e tyre nga publiku. Në mënyrë të përmbledhur politikat që do të zbatohen në këto drejtime janë:

### e-Turizmi:

- Krijimi i një baze të dhënash dixhitale e indeksuar mbi burimet, shërbimet dhe destinacionet turistike
- Aksesimi dixhital i kësaj baze të dhënash në rrjetin e brendshëm
- Aksesimi dixhital i kësaj baze të dhënash katalogut online

### e-Kultura:

- Krijimi i Rrjetit të brendshëm i institucioneve të varësisë
- Bibliotekat -Mundësimi i Katalogimit informatik dixhital të Bibliotekave
- Aksesimi dixhital i katalogut në rrjetin e brendshëm
- Aksesimi dixhital i katalogut online
- Dixhitalizim i Arkivave

## NË FUSHËN E BUJQËSISË

Në fushën e bujqësisë do të punohet në këto drejtime:

1. Krijimi i regjistrit elektronik i dixhitalizuar i parcelave të tokës, si një prioritet në këtë sektor që lidhet me funksionimin efikas të Agjencisë së Pagesave dhe është një investim me kosto të lartë.
2. Krijimi i regjistrit elektronik të fermerëve i cili është gjithashtu i rëndësishëm dhe lidhet me Agjencinë e Pagesave çon në përmirësimin e sistemit të statistikave bujqësore.
3. Realizimi i lidhjes në sistem informatik të

DRBUMK-ve, Qëndrave të Transferimit të Teknologjive Bujqësore dhe institucioneve të tjera në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit. Ky projekt është një synim i rëndësishëm i TIK në fushën e Bujqësisë dhe në krijimin e mënyrave të komunikimit sa më të shpejtë dhe efikas në këtë fushë.

## 3.3 POLITIKAT NË FUSHËN E EDUKIMIT DHE NJOHURIVE

Në dhjetor të vitit 2005 u lançua Master plani për programin e e-shkollave. Ky program i ndërmarrë nga Qeveria ka bërë të mundur informatizimin e shkollave, futjen në edukimin e nxënësve të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme të njohurive dhe përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikacionit. Deri sot 44% e nxënësve të arsimit bazë 9-vjeçar, pra 44% e afro 600 mijë nxënësve, kanë në shkollat e tyre kabinete të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, ku mësohen përdorimi i kompjuterit, i internetit dhe i teknikave dixhitale. Të gjithë nxënësit e arsimit të mesëm (afro 150 mijë) kanë kabinete TIK në shkollat e tyre. Synohet që brenda vitit të gjitha shkollat e arsimit parauniversitar të pajisen me kabinete TIK dhe të furnizohen me internet. Gjithashtu kabinetet TIK në shkolla do të jenë një vatër trajnimit e komunitetit për përdorimin e kompjuterit dhe internetit.

Projekti TIK-shkollat është komponent qëndror i nismës madhore të qeverisë për ta përfshirë Shqipërinë në epokën dixhitale. Informatizimi i shkollave është bërthama e zhvillimit dhe kjo do të mbështesë aspiratat e Shqipërisë në integrimin në Bashkimin Evropian duke siguruar edhe standarde të larta në arsim. Pjesë e këtij programi është trajnimi i mësuesve për teknikat e mësimdhënies duke përdorur teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit, si dhe modernizimi i kurrikulave. Gjithashtu qeveria do të angazhohet për përfshirjen e studenteve të teknologjisë së informacionit në programe zhvillimi, trainimi apo praktikash mësimore në administratën publike.

Hapat e ndërmarra deri tani dhe të planifikuara i shërbejnë përmbushjes së objektivave të rëndësishme të parashikuara në reformën e arsimit parauniversitar dhe të lartë si:

Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet dhe plotësimin e pasurimit të literaturës kompjuterike në gjuhën shqipe të përshtatur sipas grupmoshave të caktuara.



- Ngritja dhe instalimi i infrastrukturës së nevojshme për zhvillimin e shoqërisë së informacionit (TIK-shkolla);
- Përfshirja e njohurive të TIK në sistemin tonë arsimor;
- Krijimi i një ambienti inkurajues dhe mbështetës për zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë së informacionit në mjedise shkollore dhe universitare;
- Përfshirjen e të gjithë potencialeve kërkimore dhe shkencore në fushën e TIK-së; Krijimin dhe zhvillimin e rrjeteve komunikuese njerëzore të të gjitha llojeve dhe sidomos të atyre kërkimore dhe shkencore veçanërisht në kushtet e shoqërisë së globalizimit.

## EDUKIMI I PUBLIKUT

Krahas programit për e-shkollat një punë e madhe duhet bërë për edukimin e publikut dhe biznesit për njohuritë për teknologjinë e informacionit dhe komunikimit në mënyrë që ata të përfitojnë nga avantazhet e teknologjisë si dhe të bëhen pjesë aktive në një shoqëri të bazuar në informacion. Në këtë drejtim do të punohet për:

- rritjen e ndjeshme të nivelit të literaturës së TIK për qytetarët;
- prezantimin dhe harmonizimin e standarteve për e-edukimin;
- zhvillimin strukturor dhe të përmbajtjes dhe rritjes së prezencës së edukimit mbi TIK në të gjitha nivelet;
- promovimin e formave moderne dhe fleksibël të edukimit të mbështetur nga TIK, mësimi afatgjatë, mësimi në distancë, trainimet e përkohshme etj;
- zhvillimin e vazhdueshëm të rrjetit të kërkimit akademik si një shtyllë e veprimit modern dhe eficient të institucioneve edukuese në nivel kombëtar dhe global;

Në përputhje me objektivat e parashtruara në Strategjinë ndërsektoriale për mbrojtjen e konsumatorëve dhe mbikqyrjen e tregut për periudhën 2007-2013, në kuadër të zhvillimit të shoqërisë së informacionit përmes shfrytëzimit të rrjetit kompjuterik GovNet do të punohet për ofrimin e shërbimit online për konsumatorët për të siguruar aksesin e paraqitjes së ankesave të tyre për mallrat dhe shërbimet e ofruara në treg, tek strukturat shtetërore të mbrojtjes së konsumatorëve, gjithashtu edhe për këshillimin e tyre në rrugë elektronike e-këshillimin. Ky proces do të kryhet në bashkëpunim me Shoqatat profesionale në fushën e teknologjisë së informacionit,

shoqatat e konsumatorëve, Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë, etj. Do të organizohen aktivitete periodike si tavolina të rrumbullakta, seminare, forume, konferenca për të nxitur diskutimin me palë të interesit dhe shkëmbimin e eksperiencave më të mira.

## NË FUSHËN E KËRKIMIT SHKENCOR

Në shtator të vitit 2007, Këshilli i Ministrave miratoi statusin e vendit të asociuar, në Programin Komunitar "Programi i Shtatë Kuadër, për Kërkim e Zhvillim Teknologjik", FP7 për periudhën 2008-2013. (7th Framework Program on Research and Technological Development). Me nënshkrimin e memorandumit të mirëkuptimit me Komisionin European për pjesëmarrje në programin kuadër FP7, Shqipëria ka hedhur një hap të rëndësishëm përpara, duke ofruar një mundësi të jashtëzakonshme për universitetet shqiptare, qendrat kërkimore e shkencore, kompanite private, entet publike dhe agjensitë e ndryshme qendrore si dhe individët, për të përfituar financime, teknologji dhe eksperiencë nga Programi European FP7, i cili është instrumenti kryesor i Komisionit European për financimin e kërkimit shkencor dhe teknologjisë. Duke hequr barrierat e fundit që ndanin komunitetin e kërkuesve dhe studiuesit shqiptare nga kolegët e tyre evropianë, bëhet e mundur integrimi i mëtejshëm i vendit në Hapësirën Europiane të Kërkimit (ERA). Pjesëmarrja në programin FP7 përbën në thelb, kontributin më të madh financiar, që është dhënë në këto 15 vitet e fundit në favor të kërkimit shkencor dhe është hapi kryesor në integrimin e vendit në ERA (Hapësirën Evropiane të Kërkimit).

Objektivat kryesore të kërkimit dhe zhvillimit Kombëtar janë:

Zhvillimi i aktiviteteve promovuese kombëtare dhe ndërkombëtare për TIK.

Anëtarësimi i vendit tonë në programin FP7 realizohet duke financuar nga buxheti afro 200 mijë Euro që janë ¼ e kontributit të Shqipërisë pjesa tjetër do të mblidhet nga fondet e Bashkimit Evropian. (CARDS/IPA) ;

## 3.4 POLITIKAT NË DREJTIM TË BIZNESIT ELEKTRONIK (E-BIZNES)

- Përmirësimi i edukimit për specialistët me njohuritë dhe zhvillimet në TIK.
- Zhvillimi i rrjeteve kompjuterike për t'i shërbyer edukimit dhe kërkimit.



- Zhvillimi i zgjidhjeve të integruara teknologjike dhe aplikimeve të ndara.
- Krijimi i databazave dhe rritja e sigurisë në rrjet.
- Njohja dhe zbatimi i teknologjive të reja për edukimin dhe kërkimin në TIK.

Prezantimi i e-Business duhet të lehtësojë zhvillimin ekonomik duke siguruar një efikasitet më të mirë ekonomike, konkurrence efektive dhe fitimprurje përmes:

- riorganizimit të bizneseve dhe modernizimit të proceseve të kryerjes së biznesit. Me modelet bashkëkohore për implementimin e e-Business në kompanite dhe,
- lidhjen elektronike ndërmjet njësive të biznesit, qytetarëve, administratës publike dhe sektorit jo qeveritar;

Drejtimet strategjike të Qeverisë Shqiptare lidhur me zhvillimin e biznesit dhe investimeve përcaktohen në Strategjinë e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve të miratuar në Korrik 2007.

Kjo strategji sektoriale është pjesë përbërëse e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim dhe ka si qëllim krijimin e një partneriteti të qëndrueshëm shtet-biznes dhe krijimin e një klime nxitëse për zbatimin e politikave të investimeve dhe eksportit nëpërmjet industrializimit dhe orientimit të investimeve në degë me teknologji të lartë.

Një nga nismat e rëndësishme të ndërmarrë është reforma e procedurave të regjistrimit të biznesit. Me Ligjin "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" u themelua Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR) si një institucion i ri publik në nivel qendror. Ky ligj dhe ngritja e QKR është një nismë e qeverisë shqiptare e mbështetur nga Marrëveshja Prag e Sfidës së Mijëvjeçarit për Shqipërinë, administruar nga USAID.

Kjo reformë është një hap domethënës në programin e përgjithshëm të qeverisë për përmirësimin e klimës së biznesit në Shqipëri. Reforma synon ofrimin e përfitimeve të rëndësishme si për bizneset shqiptare edhe për investitorët e huaj, duke siguruar një proces më të thjeshtë, më të shpejtë dhe me pak shpenzime për regjistrimin e bizneseve të reja; duke siguruar regjistrimin e njëkohshëm në administratën e taksave, në sigurimet shoqërore, në sigurimet shëndetësore dhe në Inspektoriatin e Punës, nëpërmjet përdorimit të një procedure të vetme aplikimi.

Reforma e ndërmarrë në fushën e përmirësimit të ambientit të biznesit që kulmoi në vitin 2007 me ngritjen e QKR-së ka hyrë në rrugën e forcimit të vazhdueshëm të masave që Qeveria po merr në këtë drejtim. Kështu objektivi kryesor për vitin 2009 është ngritja e Qendrës Kombëtare të Licensimit, e cila do të lehtësojë në maksimum procedurat për marrjen e lejeve apo liçensave nga biznesi. Me fuqizimin e Qendrës Kombëtare të Liçensimit do të mundësohet ofrimi i shërbimit të liçensimit edhe online, duke realizuar një hap të rëndësishëm progresi për e-biznes.

## 3.5 KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

Zhvillimi i qëndrueshëm për shoqërinë e informacionit kërkon një kuadër të përbërë nga dy pjesë: ligjor dhe institucional.

### 3.5.1 LEGJISLACIONI PËR SHOQËRINË E INFORMACIONIT

Përshtatja e kornizës ligjore për shoqërinë e Informacionit në përputhje me *acquis communautaire*, me konventat ndërkombëtare dhe marrëveshjet e pranuar nga Republika e Shqipërisë do të jetë në vëmendje të vazhdueshme. Në mënyrë të veçantë legjislacioni në fushën e shoqërisë së informacionit përfshin:

I gjithë sistemi ligjor e rregullator duhet të jetë i qartë dhe i llogjikshëm, në mënyrë që të garantojë stabilitetin e zhvillimit legjislativ. Plotësimi dhe përmirësimi i legjislacionit për shoqërinë e informacionit janë në funksion të përmbushjes së pikësnyimeve të qeverisë për përputhjen e standarteve të BE në këtë fushë.

### 3.5.2 KUADRI INSTITUCIONAL PËR ZHVILLIMIN E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT

Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet ngritjes së strukturave të përshtatshme dhe efektive për implementimin e legjislacionit, zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë së informacionit. Forcimi i kapaciteteve dhe rolit të AKSHI si një njësi koordinuese për implementimin e monitorimin e implementimit të Strategjisë Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit, e cila ka si objektiva kryesorë:

- mbrojtjen e të dhënave personale dhe pronësisë intelektuale, bazën e të dhënave dhe sigurimin dhe privatësinë e të dhënave



- mbrojtjen nga krimi kibernetik biznesin elektronik (tregtia elektronike, dokumenti elektronik, nënshkrimin elektronik, pagesat elektronike)
- legjislacionin për komunikimet elektronike dhe kudirin rregullator përkatës; etj.

Disa detyra të tjera që do të kryejë Agjencia janë koordinimi i aktiviteteve për:

- Përpilimin dhe zbatimin e politikave, strategjive, akteve ligjore zyrtare dhe zhvillimin e Sektorit të Shoqërisë së Informacionit;
- Koordinimin e politikave dhe programeve në fushën e Shoqërisë së Informacionit;
- Promovimin e investimeve në fushën e Shoqërisë së Informacionit;
- Promovimin e Teknologjive të reja në fushën e Shoqërisë së Informacionit;
- Edukimin dhe nxitjen e përdorimit të TIK nga publiku.

Një rëndësi të veçantë do t'i kushtohet rritjes së njohurive, ndërgjegjësimit mbi nevojën dhe përfitimin e shoqërisë së informacionit në të gjitha nivelet e administratës qendrore dhe vendore. Vëmendje do t'i kushtohet sidomos kualifikimit të punosnjëve të teknologjisë së informacionit në administratën publike.

- zhvillimin e një rrjeti të brendshëm të TIK për administratën publike duke përfshirë një rrjet qeverisjeje (GovNet); koordinimin për informatizimin e sektorëve të ndryshëm dhe institucioneve më të rëndësishme, duke krijuar shërbime online;
- mbështetjen dhe koordinimin e projektit për dixhitalizimin e akteve ligjore, arkivave, librarive;
- nxitjen dhe mbështetjen e TIK për shkollat publike, duke përfshirë kompjuterizimin dhe aksesin në internet;
- nxitjen dhe mbështetjen e zhvillimit të biznesit elektronik;
- nxitjen dhe mbështetjen e përdorimit të shërbimeve online, internetit dhe kompjuterit nga qytetarët;
- bashkëpunimin me institucione të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, shoqëri në civile dhe sektorin privat në fushën e Shoqërisë së Informacionit.

### 3.5.3 NJË SHOQËRI INFORMACIONI E SIGURTË

Me zhvillimet e shpejta të teknologjisë së informacionit dhe me shtrirjen e përdorimit të saj pothuajse në të gjitha fushat e veprimtarisë së shoqërisë, bëhet evidente kërkesa për shërbime të sigurta dhe të besueshme.

Zhvillimi i shoqërisë së informacionit shoqërohet edhe me rritjen e kriminalitetit në fushën kibernetike. Për parandalimin e rrezikut të shfaqur nga ky lloj kriminaliteti do të punohet për ngritjen e strukturave të specializuara të policisë, krahas përmirësimit dhe plotësimit të legjislacionit në fushën e krimeve kibernetike;

Një rëndësi të veçantë merr ndërgjegjësimi ndaj rrezikut nga krimi kibernetik. Për këtë Qeveria do të angazhohet në ndërmarrjen e aktiviteteve të ndryshme për:

- Sensibilizimin e grupeve të ndryshme të interesit: shkollat, familjet, institucionet financiare, kompanitë e biznesit, shoqatat e konsumatorit; shoqatat e IT etj;
- Inkurajimin e hartimit dhe zbatimit të kodeve të etikës nga ISP;
- Mbikqyrjen dhe filtrimin e informacionit të shpërndarë në rrjetet e shkollave për parandalimin e rreziqeve që mund të sjellë informacioni nga Interneti;
- Bashkëpunimin ndërinstitucional midis strukturave të ndryshme të teknologjisë së informacionit për sensibilizimin e grupeve të interesit dhe parandalimin e rreziqeve;



**Tabela përmbledhëse e drejtimeve kryesore të politikave për  
zhvillimin e shoqërisë së informacionit**

<b>INFRASTRUKTURA (SHËRBIMET ME BREZ TË GJERË, BROADBAND)</b>		
Akresi broadband shihet si qendra e zhvillimit ekonomik dhe më një impakt të ndjeshëm në ekonomi bazuar në informacion	Hartimi i një Politike, programi kombëtar për zhvillimin e shërbimeve/aksesit broadband;	Përshtatja e Politikave që duhet të sigurojnë një konkurrencë efektive në rrjetet lokale të telekomunikacioneve për të përshpejtuar zhvillimin e rrjeteve broadband. Politikat e zhvillimit duhet të fokusohen në çështjet ku konkurrenca nuk është efektive; përshtatja e politikave spektrale për të rritur eficienten e përdorimit për shërbimet wireless broadband ; Mundësitë e sigurimit të aksesit në zonat pak të favorizuara ;
<b>OFRIMI I SHËRBIMEVE MODERNE “ONLINE”</b>		
<b>e-Government</b>	ofrimi i shërbimeve bazë on line – të sigurta	<ul style="list-style-type: none"> <li>- lidhje broadband për të gjithë administratën publike pavarësisht teknologjisë;</li> <li>- shërbime publike interaktive;</li> <li>- prokurimi publik</li> <li>- krijimi i Pikave publike të aksesit të Internetit në çdo bashki/komunë</li> <li>- përcaktimi i shërbimeve online për kulturën/turizmin</li> </ul>
<b>e-Edukimi</b>	lidhja e shkollave dhe universiteteve me lidhje broadband	<ul style="list-style-type: none"> <li>- rritja e aftësive /njohurive për shoqërinë e informacionit;</li> <li>- krijimi i kampuseve virtuale për të gjithë studentet;</li> </ul>
<b>e-Shëndetësia</b>	Pajisja me karta elektronike shëndetësore që do të zëvendësojnë formën manuale të të dhënave shëndetësore;	<ul style="list-style-type: none"> <li>- ngritja e rrjeteve të informacionit shëndetësor- të ngrihen rrjetet e informacionit shëndetësor në spitale, laboratore etj;</li> <li>- shërbimet on-line për shëndetin</li> <li>- dhënia e informacioneve për një jetë të shëndetshme, mbi parandalimin e sëmundjeve etj;</li> </ul>
<b>NJË AMBIENT DINAMIK PËR E-BIZNESIN</b>		
I besueshëm dhe konfidencial	Krijimi i një infrastrukture informacioni të sigurtë	<ul style="list-style-type: none"> <li>- krijimi i një strukture të specializuar për sigurinë ndaj krimeve të kibernetikës;</li> <li>- rritja e kulturës mbi sigurinë</li> <li>- sigurimi i komunikimeve të sigurta ndërmjet shërbimeve publike;</li> </ul>





KAPITULLI

4

# BURIMET E FINANÇIMIT, MONITORIMI DHE VLERËSIMI

## 4.1 BURIMET E FINANÇIMIT

Buxhetimi dhe financimi duhet të bëhet përmes burimeve të vazhdueshme të financimit. Këto fonde duhet të sigurohen në mënyra të ndryshme nga qeveria, sektori privat, dhe donatorë të huaj.

Planifikimi i aktiviteteve të TIK duhet të bëhet në përputhje me SKZHI dhe t'i shërbejnë përbushjes së objektivave për zhvillimin e shoqërisë së informacionit.

Nga secila ministri e linjës/institucion buxhetor përgjegjëse për implementimin e strategjisë, gjatë procesit të planifikimit buxhetor afatmesëm PBA, do të bëhet specifikimi i produkteve, aktiviteteve dhe kostove të tyre për llogari të TIK. Kjo do të bëjë të mundur evidentimin dhe monitorimin e qartë të nivelit real të angazhimit të tyre dhe përbushjes së objektivave të kësaj strategjie.

## 4.2 MEKANIZMI I IMPLEMENTIMIT, MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT

Procesi i implementimit të strategjisë do të realizohet në nivel lokal dhe kombëtar. Në nivel kombëtar, përgjegjësia për implementimin e komponenteve të strategjisë do t'i përkasë ministrive dhe departamenteve përkatëse, ndërsa në nivel lokal përgjegjësia për implementimin do t'i përkasë administratës publike lokale.

Në nivel kombëtar, procesi i implementimit të Strategjisë do të udhëhiqet nga Grupi Ndërinstitucional i ngritur me Urdhërin e Kryeminis-

trit Nr. 72, të datës 11.6.2008, nën kryesimin e Zëvendëskryeministrit. Grupi do veprojë në nivel vendimmarrje, ndërkohë nga pikëpamja operationale AKSHI do të luajë rolin e koordinatorit për zhvillimin e shoqërisë së Informacionit. AKSHI do të bashkëpunojë me të gjitha institucionet e përfshira në grupin ndërinstitucional dhe me institucione të tjera kyçe si Agjencia e Prokurimit Publik, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave etj. që ftohen të marrin pjesë në grupin ndërinstitucional të punës për implementimin e strategjisë për zhvillimin e shoqërisë së informacionit.

Ministritë, departamentet dhe autoritetet lokale do të përcaktojnë personat përgjegjës dhe ndarjen e përgjegjësisë për implementimin e TIK në degët pëkatëse. Ministritë përgjegjëse dhe administrata publike lokale do të bashkëpunojnë me shoqërinë civile dhe organizmat privatë. Implementimi i disa aktiviteteve të planit të veprimit të Strategjisë mund t'u delegohen organizatave joqeveritare.

Implementimi i proceseve të strategjisë do të monitorohet me anë të një grupi treguesish, gjerësisht të përdorur në vendet e Bashkimit Europian.

## 4.3 MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Zhvillimi i një procesi monitorimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm i rezultateve të arritura në zhvillimin e shoqërisë së informacionit, është i domosdoshëm për të bërë vlerësimin dhe përcaktimin e politikave në të ardhmen dhe planet strategjike. Në përpunimin dhe vlerësimin e këtyre treguesve do të bashkëpunojë me INSTAT dhe institucio-



net e tjera që përgjigjen për mbledhjen e përpunimin e treguesve statistikore në fushën e teknologjisë së informacionit.


- shkalla e përdorimit
- shërbimet dhe shpejtësia e ofruar
- çmimet

## 4.4 TREGUESIT PËR ZHVILLIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Treguesit e zhvillimit të teknologjisë së informacionit grupohen në pesë drejtime kryesore.

- penetrimi
- mbulimi me shërbim

Në rastin e monitorimit të zhvillimit të shoqërisë së informacionit, treguesit teknike apo të teknologjisë informacionit (TIK) normalisht kombinohen me faktore të tjerë sikurse shkollimi, aftësitë dhe mundësitë e përthithjes së informacionit etj. Më poshtë jepet një grupim i treguesve dhe nëntreguesit që shërbejnë për vlerësimin, indeksin e mundësisë për Teknologjinë e informacionit bazuar në Infodensity dhe Infouse.



**Për ndjekjen e implementimit të strategjisë së shoqërisë së informacionit do të jenë në vëmendje treguesit që jepen në tabelën në vijim:**

TREGUESIT E INTERNETIT	
<b>Aksesi dhe përdorimi i internetit në shoqëri</b>	
	1. Përqindja e personave që kanë akses interneti në shtëpi
	2. Përqindja e personave që kanë akses të rregullt interneti, total ose/dhe të ndarë sipas moshës, seksit, edukimit, zonës së banimit apo aktiviteteve
<b>Aksesi dhe përdorimi i TIK në biznes</b>	
	3. Përqindja e punonjësve që përdorin kompjutera me lidhje interneti në punën e tyre të përditshme, e ndarë sipas tipit të ndërmarrjes apo aktivitetit
<b>Kostoja e aksesit në Internet</b>	
	4. Çmimet e aksesit në internet, e ndarë sipas zonave dhe teknologjisë së përdorur



SHËRBIMET MODERNE PUBLIKE ON-LINE	
e-Qeverisja <sup>21</sup>	
	5. Numri i shërbimeve publike, totalisht të aksesueshme on-line
e-Edukimi	
	6. Numri i nxënësve për kompjuter të lidhur në Internet (të përdorur për qëllime trainimi), të ndarë sipas tipit të institucionit arsimor dhe vendndodhjes gjeografike
	7. Numri i nxënësve / studentëve për një kompjuter, të ndarë sipas tipit të institucionit arsimor dhe vendndodhjes gjeografike
	8. Numri i nxënësve për kompjuter të lidhur në Internet, të ndarë sipas tipit të institucionit arsimor dhe vendndodhjes gjeografike
e-Biznesi	
	9. Blerjet dhe porositë on-line
	10. Përqindja e tregtisë elektronike (e-commerce)
	11. Indeksi i gatishmërisë për e-BUSSINES
Siguria e informacionit	
	12. Eksperienca e përdoruesve të Internetit mbi sigurinë TIK
	13. Përqindja e përdoruesave që kanë probleme sigurie (viruse, hackers)
	14. Përqindja e kompanive me akses në internet që kanë probleme sigurie
Akresi broadband	
	15. Penetrimi broadband
	16. Prezenca e aksesit broadband (përqinda e familjarëve) sipas tipit të platformës
	17. Përqindja e kompanive me akses broadband në Internet
	18. Përqindja e përdoruesve familjare apo individeve me akses broadband në Internet
	19. Përqindja e agjencive të administratës publike me akses broadband

Krahas këtyre treguesve për vlerësimin e zhvillimit të shoqërisë së informacionit do të kushtohet vëmendje e vijueshme treguesve të monitorimit të organizatave ndërkombëtare si UN, ITU, Eurostat.

## 4.5 RAPORTIMI

Institucionet përgjegjëse për aktivitetet dhe politikat e përcaktuara në këtë dokument do të raportojnë periodikisht pranë Grupit Ndërinstitucional të kryesuar nga Zëvendëskryeministri, mbi statusin e realizimit të tyre. Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit do të jetë koordinator.



## Grupi Ndërinstitucional

Zëvendëskryeministri (Kryetar)  
 Zv.Min. i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjistikës  
 Zv.Ministri i Financave  
 Zv.Ministri. i Drejtësisë  
 Zv.Ministri i Arsimit dhe Shkencës  
 Zv. Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit  
 Zv. Ministri i Shëndetësisë  
 Zv.Ministri i Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit  
 Zv.Ministri i Brendshëm  
 Zv. Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta  
 Zv. Ministri i Kulturës Rinisë dhe Sporteve  
 Drejtori i Përgjithshëm i AKSH-it



**KOORDINATORI**  
 Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit



- e-PBA
- e-Thesari
- e-Taksa
- e-Doganat
- e-Sigurimet Shoqërore
- e-Drejtësia
- e-Kabineti
- e-Tregtia
- e-Regjistrat dhe Adresat
- Karta e Identitetit & e-Pashaporta
- e-Punësimi në Administratën Publike
- e-Edukimi
- e-Kërkimi
- e-Prokurimi
- Zhvillimi i infrastrukturës
- Broadband
- Treguesit e monitorimit etj.

## Plani i Veprimit

AKTIVITETET		PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT	INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE	TREGUESIT MONITORUES	AFATI I REALIZIMIT	
<b>I. Përmirësimi i infrastrukturës së teknologjise së informacionit dhe komunikimit</b>						
I.	1	Zhvillimi i Infrastrukturrës	Futja e operatorëve të rinj në teknologjitë Wireless dhe NGN;	MPPTT, AKEP	rritja e përdoruesve të Internetit, dhe Broadband; Çmimet e aksesit në internet, e ndarë sipas zonave dhe teknologjisë së përdorur	
I.	2		Hartimi i planit kombëtar për zhvillimin e Broadbandit	MPPTT		2008-09
I.	3		Plotësimi i Kuadrit Rregullator në përputhje me direktivat BE	AKEP		2009
<b>II. Zhvillimi i qeverisjes elektronike dhe i shërbimeve publike</b>						
1.	4	Institucion më pak Shkresa	Projektimi dhe Implementimi i një Dokument Management System për një Ministri	AKSHI	Përqindja e agjencive të administratës publike me akses broadband	
	5		Shtirja e këtij sistemi në 5 Institucione të tjera	Për t'u vendosur		2009
	6		Shtirja e këtij sistemi në të gjithë administratën qendrore	Për t'u vendosur		2012
2.	7	Arkiva Dixhitale	Projektimi dhe Implementimi i një Sistemi Elektronik për Arkivin Dixhital	AKSHI	Përqindja e punonjësve që përdorin kompjutera me lidhje interneti në punën e tyre të përditshme, e ndarë sipas tipit të ndërmarrjes apo aktivitetit	
	8		Shtirja e këtij sistemi në 5 Institucione të tjera	Për t'u vendosur		2010
	9		Shtirja e këtij sistemi në të gjithë administratën qendrore	Për t'u vendosur		2012
3.	10	Standartizimi	Standartizimi i Hartimi dhe Miratimi i Standarteve për: LAN, Serverat, Pajisjet për LAN, PC, Laptop, Printer, softuer,	AKSHI	Numri i shërbimeve publike, totalisht të aksesueshme on-line	
4.	11	e-Kabinet	Projektimi dhe Implementimi i mbledhjeve të qeverisë 'online	Këshilli i Ministrave, AKSHI	2009	
5.	12	e-gov	Lidhja me rrjet online i METE me institucionet e vartësisë	METE	2009	
6.	13	EAMIS	Krijimi i bazës së të dhënave për burimet natyrore dhe aktivitetit minerar, ofrimi i shërbimit online	Keshilli i Ministrave	2009-10	
7.	14	e-gov	Krijimi i bazës së të dhënave për burimet natyrore dhe aktivitetit minerar, ofrimi i shërbimit online	METE	2009	



III.		Shërbimet publike				
1.	15	Administrimi i Identitetit të Shtetasit	Rregjistri themeltar dhe sitemimi i adresave	MB	Krijimi i nji baze të saktë të dhënash për të gjithë shtetasit shqiptarë	2008
	16		Karta e Identitetit dhe Pasha-porta Elektronike	MB	Pajisja e të gjithë shtetasve me Karta Identiteti me parametra biomentrik	2009
2.	17	e-Dogana	Implementimi i sistemit automatik i përpunimit të të dhënave ASYCUDA si dhe migrimi në sistemin ASYCUDA WORLD	Ministria Financave (MF)	Sistemi Automatik i përpunimit të të dhënave	2009-10
3.	18	e-Prokurim	Prokurimi Elektronik	APP	Realizmi i 80% të prokurimeve publike në formë elektronike	2009
4.	19	e-Sigurime Shoqërore	Prokurimi Elektronik	MF		
5.	20	e-Punësim	Implementimi i një baze të të dhënave mbi Punësimin	MPCSShB		
6.	21	e-Patenta	Aplikimi elektronik për Patentën dhe marrjen e një shërbimi të shpejtë	MPPTT	Realizimi i 80% të punës në formë elektronike	2009-10
7.	22	e-Thesari	Implementimi i një sistemi elektronik	MF	Kalimi në masën 100% në formë Elektronike	2009
8.	23	e-Kadastra	Implementimi i një sistemi elektronik për ZRPP me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve si dhe rritjen e transparences	MinDrejtësi	Ofrimi i shërbimeve online	2009-10
9.	24	e-visa	Implementimi i sistemit të aplikimit online për viza fillimisht një projekt pilot në 2008 dhe me pas implementimi në të gjitha ambasadat	MinJashtme	Shkalla e aplikimeve online në ambasada	2009-10
10.	25	e-Regjistri Kredive	Implementimi i një baze të të dhënave mbi kreditë (Sistemi i Kredive do të ndihmonë Bankar të analizimin e riskut dhe parandalimin e situatave negative)	Banka e Shqipërisë		Realizuar
11.	26	e-Statistika	Deklarimi, analizimi dhe publikimi i të dhënave nga INSTAT në përputhje me metodologjinë dhe standardet e EUROSTAT (Statistika me të sakta sipas standardeve të EUROSTAT)	INSTAT		2009-2010
12.	27	Biblotekat Virtuale	Ofrimi i një pjese të përbajtjes, katalogimit dhe kërkimit në Bibloteka në formë elektronike	MTRKS		2012
13.	28	e-Turizmi	Ofrimi i mundësisë së rregjistrimit, katalogimit dhe rezervimit nëpërmjet Sistemeve Elektronike	MTRKS	Nr. i kartelave dhe Nr. i vizitorëve	2010



14.	29	e –Kulturë	Katalogimi informatik i pasurive kulturore dhe dalja e tyre në internet për konsultim nga publiku	MTRKS		2009
15.	30	GIS		MPPTT/ ALUIZNI		2009-10
<b>IV. Edukimi dhe përhapja e njohurive</b>						
1.	31	e-Edukim	Pajisja e të gjitha shkollave të arsimit parauniversitar me laboratore të TIK	MASH	Numri i nxënësve për kompjuter të lidhur në Internet (të përdorur për qëllime trainimi), të ndarë sipas tipit të institucionit arsimor dhe vendndodhjes gjeografike	2009
2.	32		Aplikimi Online për sitemin Universitar	MASH	Përqindja e personave që kanë akses interneti në shtëpi	2010
3.	33		Adaptimi i TIK në metodologjinë e mësimdhënies	MASH	Përqindja e përdoruesve familjare apo individëve me akses broadband në Internet  Numri i nxënësve / studentëve për një kompjuter, të ndarë sipas tipit të institucionit arsimor dhe vendndodhjes gjeografike  Numri i nxënësve për kompjuter të lidhur në Internet, të ndarë sipas tipit të institucionit arsimor dhe vendndodhjes gjeografike	2010
<b>V. Nxitja e përdorimit të teknologjive të informacionit dhe komunikimit nga biznesi</b>						
1.	34	1-StopShop	Regjistrimi i bizneseve	METE	Akresi dhe përdorimi i TIK në biznes	Realizuar
2.	35	e-license	Krijimi i Qëndres Kombëtare të Liçensimit	METE	Ngritja e qendrës	Në proces 2009
3.	36	e-Taxes	Regjistrimi, Pagesat dhe analiza e situatës së Tatim-Taksave	MF	Mundësia e marrjes të shërbimeve të Tatim-Taksave vetëm në formën Elektronike	2009/10
4.	37	e-TVSH	Deklarimi, analizimi, kryerja e të gjitha procedurave dhe rimbursimi i TVSH në formë elektronike	MF	Manaxhimi TVSH në formë elektronike në masën 80%	2009/10
<b>VI. Përmirësimi i legjislacionit për shoqërinë e informacionit.</b>						
1.	38	Korniza Ligjore	Hartimi dhe aprovimi i disa ligjeve në fushën e TIK	GoA	Shkalla e harmonizimit me Aquis Comunitaire	2008-2009
2.	39	Koniza nën-Ligjore	Hartimi dhe Aprovimi i rregulloreve për: Postën Elektronike, Faqet e Internetit, Përdorimin e Internetit, Sigurinë, Strukturën e Domain,	AKSHI	Aprovim dhe Monitorim në Institucionet Qëndrore	2008-2009



### METE: Aktivitete ne kuadrin e nxitjes se biznesit (Sipas Strategjise per nxitjen e zhvillimit dhe investimeve)

<b>Masat dhe veprimet për t'u marrë</b>	<b>Institucioni pergjegjes</b>	<b>Treguesit monitorues</b>	<b>Afati i realizimit</b>	<b>Kosto</b>
Përmirësimi i kuadrit rregullator, heqja e pengesave administrative që sjellin kosto të tepërta gjatë krijimit dhe veprimtarive të ndërmarrjeve	METE, MF	Reduktimi i numrit të liçensave	2007-2011	188 milion lekë <sup>22</sup>
Instalimi i Analizës së impaktit rregullator (RIA)	METE	Analiza e impaktit të ligjeve të miratuara në biznes	2008	246 milion lekë
Krijimi i një sistemi taksash që lehtëson sektorin e SME-ve	MF, Drejtoria e Tatimeve, METE, Albinvest	Sistemi i thjeshtë për pagesat	2007-2010	
Studim fizibiliteti për rishikimin e modelit të regjistrimit të biznesit	METE, MF, MD	Studimi përkatës	2007	246 milion lekë
Krijimi i Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit	METE, M. e linjës	Koha e hapjes së biznesit 1 ditë	2007-2008	123
Zhvillimi i kapaciteteve të SME-ve	METE, Albinvest	Strategjia, trainime, studime sektoriale	2008-2013	50

## Aktivitetet te parashikuara nga Ministria e Shëndetësisë

Fusha e TIK	Aktiviteti	Kostoja e projektit dhe Burimi i financimit	Institucionet pergjegjës	Buxheti	Statusi
e-Gov	Sistemi elektronik për ruajtjen dhe menaxhimin e dokumenteve	5 000 000 lek Buxheti i MSH	MSH	Parashikuar 2008	Filluar
E-Health	Shtrirja e Sistemit te Menaxhimit te Aktivitetit Shëndetësor ne Shërbimin Parësor	25 000 000 lek Buxheti i MSH	MSH / ISKSH	Parashikuar 2008	Filluar
E-Health	Krijimi i një sistemi informacion për Menaxhimin e Paketës Statistikore Shëndetësore	5 000 000 lek Buxheti i MSH	MSH	Parashikuar 2008	Filluar
e-Gov	Lidhja Online e Ministrisë së Shëndetësisë me Drejtoritë e Shëndetit Publik në nivel Qarku	12 000 000 lek Buxheti i MSH	MSH	Parashikuar 2008 (pjesë e buxhetit për Sistemin e Informacionit në Shërbimin Parësor)	Filluar
e-Gov	Regjistrim i punonjësve në sistemin publik shëndetësor	25 000 000 lek Buxheti i MSH	MSH	Parashikuar Draft buxhetin 2009	Parashikuar
E-Gov	Krijimi i rrjetit Health – NET për lidhjen Intranet të institucioneve të Tiranës	E papercaktuar Buxheti i MSH	MSH	Parashikuar 2009	Parashikuar
E-Health	Ngritja e Sistemit të Informacionit për kompjuterizimin e procedurave të liçensimit të aktivitetit shëndetësor privat	3 000 000 lek Buxheti i MSH	MSH	Parashikuar 2009	Parashikuar
E-Health	Ngritja e një Baze të Dhënash për indikatorët e mjedisit dhe shëndetit	2 000 000 lek Buxheti i MSH	MSH	Parashikuar Draft buxhetin 2009	Parashikuar
E-Gov	Administrimi Financiar i Aktivitetit Shëndetësor	22 000 000 lek Buxheti i MSH	MSH	Parashikuar Draft buxhetin 2009	Parashikuar
E-Health	Krijimi i një sistemi të integruar informacioni kombëtar për Health Management System	Shifra është në varësi të sistemit Banka Botërore	MSH / ISKSH	Afatgjatë	



**Ministria e Arsimit dhe Shkencës Projektet/ objektivat për reformën  
"Cilësi dhe barazi në arsim" për vitin 2008**

<b>Objektiva</b>	<b>Aktivitetet</b>	
1.3 Deri më dhjetor 2008 funksionon EMIS për vendimarrje në MASH dhe në DAR	1.3.1 Blerje e software për EMIS.	Mbi Bazen e asistencën teknike të konsulentit do të blihen software për mirëfunksionimin e EMIS
	1.3.2 Asistencë teknike-konsulence lokale për EMIS	Asistenca do të përdoret për përdorimin efektiv të softwareve për EMIS-n
	1.3.3 Trajnimi i personelit të MASH, IKT, AVA, DAR dhe të qeverisjes vendore në përdorimin e EMIS.	Trajnim i të gjithë përdoruesve
	1.3.4 Trajnimi i personelit të DIS për menaxhimin e sistemit të informacionit	Trajnim për vënien në funksionim të emis në bazë të tipit të serverave
	1.3.5 Blerja dhe instalimi i sistemit qëndror të informatizimit në MASH dhe në DAR (SISTEMI WAN)	Krijimi i sistemit LAN të DAR/ZA do të arrihet komunikimi në rrjet midis DAR/ZA-ve dhe MASH-it
	1.3.6 Rishikimi i website të Mash në përputhje me nevojat e programit EEE-P	
	1.3.7 Trainimi i mësuesve të shkollave të arsimit bazë që pajisen me laboratorë informatike në fushën e TIK.	Trajnimi i mësuesve për përdorimin e laboratorëve të informatikës në fushën e mësimdhënies
	1.3.8 Lidhja me internet në fushën e TIK.	Do të lidhen me Internet për një periudhë 1 vjeçare shkollat e pajisura me laboratorë informatike, në kuadër të projektit qeveritar

**Fusha prioritare 2 – Përmirësimi i kushteve të mësimnxënies**

	2.1.11 Konsulencë lokale për e-school	
--	---------------------------------------	--

**Fusha prioritare 3 – Përmirësimi dhe racionalizimi i infrastrukturës arsimore**

	3.2.3. Blerje e sistemit operativ , paketa office dhe software për menaxhimin e laboratorëve të informatikës të instaluar.	Sipas marrëveshjes së nënshkruar midis qeverisë shqiptare dhe "Microsoft" do të blihen sisteme operative, paketa office dhe soft për menaxhim e laboratorëve të informatikës me kosto minimale për të arritur mirëfunksionimin e laboratorëve të informatikës.
	3.2.4 Studimi i fizibiliteti dhe pilotim i lidhjes në rrjetin e sistemit arsimor	Studimi dhe përgatitja e projektit për rrjetin kombëtar arsimor. Pilotimi i këtij rrjeti do të bëhet në 2-3 qytete të mëdha
	3.2.5 Shtimi i numrit të laboratorëve kompjuterikë në shkollat 9 vjeçare sipas një strategjie dhe kritereve të paracaktuar	Përfundon pajisja me laboratorë informatike 80% të shkollave 9 vjeçare. Përfitojnë rreth 700 shkolla në të gjithë vendin.
	3.2.6 Mbështetja me pajisje mobile për funksionimin e laboratorëve kompjuterikë	Përfundon sistemi Informatikës të shkollave 9 vjeçare. Përfitojnë rreth 700 shkolla në të gjithë vendin me rreth 400'0000 nxënës





## Ministria e Financave Projekte të realizuara dhe te parashikuara në fushën e TIK

Projekti	Fusha e TIK	Aktiviteti	Kostoja e projektit dhe Burimi i financimit	Statusi
1.	E-government E-financing	Sistemi kompjuterik i financave publike (sistemi thesarit)	Afërsisht 6 milion USD Banka Botërore/ Buxheti Shtetit	Mbaruar funksional nga 3 janar 2008 ; <b>Koment :</b> Mirëmbahet dhe menaxhohet nga IT-ja dhe pjesa funksionale e ministrisë dhe po negociohet me firmën për një kontratë suporti on-line IT+funksional për soft-in
2.	DMFAS (debt management)	Sistemi i borxhit	UNCTAD/BANKA BOTERORE/MINIS- TRIA FINANCEVE	Mbaruar në shfrytëzim dhe me update të sistemit me variantin e fundit. <b>Koment:</b> Mirëmbahet nga IT-ja e MINFIN-it dhe ka një kontratë mirëmbajtjeje vjetore për soft-tin me kompaninë
3.	MTBP (medium term budget preparation)	Sistemi i Buxhetimit Afatmesëm	DFID	Mbaruar është në përdorim. Këtë vit kalon pronë e Ministrisë së Financave. <b>Koment:</b> Sistemi do të mirëmbahet dhe menaxhohet nga IT, po subkontraktohet firma e softit për pjesën software-ike
4.	e-accounting	Sistemi i menaxhimit të Inventarit	300.000 USD 50.000 USD mirëmbajtje UNDP	Ka mbaruar dizenjimi dhe implementimi në negociata për kontratën e mirëmbajtjes dhe suportin on-line, funksional



## Aktivitete të realizuara nga Ministria e Mjedisit në fushën e TIK

Projekti	Fusha e TIK	Aktiviteti	Kostoja e projektit dhe Burimi i financimit	Statusi
1.	Zhvillimi i shërbimeve online për mjedisin	Forcimi i kapaciteteve në vendet Ballkanike në raportimin dhe zhvillimin e rrjetit EIONET	Projekti CARDS 2.000.000 Euro	Kohezgjatja: 1.3.2003 - 28.2.2006
2.	Shkëmbimin e informacionit për biosigurinë	Krijimin e kapaciteteve dhe pjesëmarrje aktive në mekanizmin e shkëmbimit të informacionit për biosigurinë	47.439 \$ UNEP 21.800 \$ kontribut in kind MMPAU 600 000 lekë kosto lokale MMPAU	Mbaruar 1.9.2006 - 30.7.2007

## Aktivitete të zhvilluara nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

Projekti	Fusha e TIK	Aktiviteti	Kostoja e projektit dhe Burimi i financimit	Statusi
1.	Shërbime Punësimi Eficente në Shqipëri	Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të punësimit Zhvillimi i një sistemi të ri të menaxhimit të informacionit të tregut të punës, etj.	300 000 Euro nga SIDA, Suedeze; Kosto lokale 5 milion lekë	Kohezgjatja: 2004-2007

## Aktivitete të parashikuara nga Ministria e Punëve të Jashtme

Projekti	Fusha e TIK	Aktiviteti	Kostoja e projektit dhe Burimi i financimit	Statusi
1.	e- government ofrimi i shërbimeve online për ambasadat	Krijimi i një portali për ambasadat: zbatimi i një sistemi të qendëruar të administrimit dhe të publikimit të faqeve web të Ministrisë dhe zyrave të përfaqësimit	70 000 000 lekë nga Buxheti i shtetit	Parashikuar viti 2008



Aktivitete të AKSHI			
No	Aktiviteti	Plani i Veprimit	Periudha
1.	Krijimi i një plani veprimit për sigurinë dhe menaxhimin e rrjetit GovNet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përgatitja nga AKSHI e inspektimit të gjendjes aktuale të GovNet.</li> <li>• Përgatitja e politikave dhe udhëzimeve për menaxhimin e sigurisë në GovNet</li> <li>• Përgatitja e ToR-eve për përditësimin e sigurisë dhe menaxhimin të GovNet</li> <li>• Përgatitja e standarteve dhe dokumentit benchmark për GovNet</li> <li>• Përgatitja e standarteve dhe dokumentit benchmark për elementet e sigurisë pas implementimit të sigurisë dhe menaxhimin të GovNet.</li> </ul>	2009
2.	Krijimi i termave të referencës si dhe implementimi i sistemit të menaxhimin të dokumentave, dhe arkivës dixhitale	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përgatitja e planit të veprimit për sistemet e informacionit për menaxhimin e dokumentave dhe arkivës dixhitale</li> <li>• Krijimi i termave të referencës për sistemet e informacionit për menaxhimin e dokumentave dhe arkivës dixhitale</li> <li>• Përgatitja e dokumentit benchmark për sistemet e informacionit për menaxhimin e dokumentave dhe arkivës dixhitale</li> <li>• Përgatitja e planit të detajuar për implementimin e sistemit e informacionit për menaxhimin e dokumentave dhe arkivës dixhitale në të gjithë ministrinë të linjës dhe 4 agjenci (AKSHI, APP, QKR, QPZ, DPA)</li> </ul>	2009 2010
3.	Përgatitja e arkiteturës në ICT dhe kuadrit për standardizimet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përgatitja e dokumentit për standardet në pajisjet e përdorura në GovNet dhe institucione si; servera, kabllimi dhe shpërndarja, pajisjet e rrjetit dhe komunikimit, kompjuterat personal dhe laptop, pajisje të tjera</li> <li>• Përgatitja e dokumentit për standardet në programet software-ike të përdorura në GovNet dhe institucione si; software në kompjutera personal dhe laptop, software në servera, aplikacione software dhe bazë të dhënash, software dhe sisteme menaxhimin të proceseve të punës</li> <li>• Përgatitja e dokumentit për pajisjet e sigurisë dhe maseve të përdorura në GovNet, duke përfshirë politika dhe rregullore për përdorimin e emailit, internetit, strukturës së domain-it etj</li> <li>• Përgatitja e Workshop për të gjitha standardet e paraqitura</li> </ul>	2009 2009
4.	Përgatitja e kurikulave për edukimin në ICT	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përgatitja e kurikulave për punonjësit e sektorit IT në qeveri</li> <li>• Përgatitja e materialeve për trajnimin e stafit IT të qeverisë</li> <li>• Përgatitja e konferencës me pjesëmarrjen e stafit IT në qeveri.</li> </ul>	2009
5.	Përgatitja e Kuadrit të Nderveprimit për sistemet ICT	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vlerësimi i situatës aktuale të ICT, i projekteve korente dhe i bazës ligjore në lidhje me sistemet informatike dhe databazave të përdorura në qeveri.</li> <li>• Përgatitja e strategjisë dhe planit të veprimit me qëllim zhvillimin e ndërveprimit në sistemet informatike të qeverisë.</li> <li>• Përgatitja e standarteve që duhet të respektohen nga stafi IT i institucioneve me qëllim zhvillimin dhe ruajtjen e kuadrit të ndërveprimit</li> <li>• Rregullimet dhe përmirësimet e nevojshme të bazës ligjore përkatëse me qëllim zhvillimin e kuadrit të ndërveprimit</li> <li>• Koordinimi dhe bashkëpunimi në nivel organizacional me qëllim zhvillim e kuadrit të ndërveprimit</li> <li>• Zhvillimi i një "exchange layer" që do mundësojë shkëmbim të sigurtë të dhënash (internet-based) ndërmjet sistemeve informatike dhe databazave</li> </ul>	2009



## Treguesit e monitorimit për qeverisjen elektronike

Mbi bazën e të dhënave mbi gadishmërinë e qeverisjes elektronike, në raportin e Kombeve të Bashkuara: "UN e-Government Survey 2008", Shqipëria renditet në vendin e 86 ndër 182 të konsideruara në këtë raport, me një rritje prej 14 vendesh kundrejt vëzhgimit të kryer në vitin 2005; Në tabelën e mëposhtme jepet indeksi për qeverisjen elektronike të vendeve të Europës Jugore.

### E-Government Readiness for Southern Europe

COUNTRY	2008 INDEX	2005 INDEX	2008 RANKING	2005 RANKING
Spain	0.7228	0.5847	20	39
Slovenia	0.6681	0.6762	26	26
Italy	0.6680	0.6791	27	25
Malta	0.6562	0.7012	29	21
Portugal	0.6479	0.6004	31	30
Greece	0.5718	0.5921	44	35
Croatia	0.5650	0.5480	47	47
Andorra	0.5175	0.1836	58	159
T.F.Y.R Macedonia	0.4866	0.4833	73	69
Serbia	0.4828	0.1900	77	156
Albania	0.4670	0.3732	86	107
Bosnia and Herzegovina	0.4509	0.4019	94	84
Montenegro	0.4282	0.1960	100	153
San Marino	...	0.3110	...	124
<b>Region</b>	<b>0.5647</b>	<b>0.4654</b>		
<b>World</b>	<b>0.4514</b>	<b>0.4267</b>		

Treguesi i gatishmërisë për qeverisjen elektronike, i paraqitur në raportin: "UN e-Government Survey 2008" llogaritet nga Departamenti i Çështjeve Ekonomike dhe Sociale i Kombeve të Bashkuara, si një tregues i përbërë i cili merr në konsideratë treguesit e infrastrukturës, të gatishmërisë së të dhënave, të aksesit në web; treguesin e edukimit, etj.

Më poshtë po japim në formë tabelare këta tregues duke i krahasuar me vendet e tjera të rajonit, referuar të njëjtit burim: "UN e-Government Survey 2008".

## Indeksi i infrastrukturës

	SHQIPËRIA	MALI I ZI	BOSNJE& HERCEGOVINA	GREQI	MAQEDONI	BULLGARI	RUMANI
Indeksi i internetit	0.169	0.028	0.273	0.207	0.148	0.274	0.364
Indeksi i PC	0.19	..	0.60	0.101	0.245	0.070	0.143
Indeksi i telefonisë celulare	0.321	0.049	0.316	0.656	0.457	0.709	0.529
Indeksi i telefonisë fikse	0.117	0.035	0.262	0.576	0.250	0.324	0.201
Indeksi për BBand	0	0.08	0.032	0.138	0.056	0.158	0.258
Indeksi i infrastrukturës	0.1251	0.0240	0.1887	0.3356	0.2314	0.3071	0.2992

## Treguesi i gatishmërisë elektronike të të dhënave

	SHQIPËRIA	MALI I ZI	BOSNJE& HERCEGOVINA	GREQI	MAQEDONI	BULLGARI	RUMANI
e-readiness data	0.3913	0.3712	0.2943	0.4147	0.3579	0.4849	0.4147
Web measured access	0.3913	0.3712	0.2943	0.4147	0.3579	0.4849	0.4147

## Në tabelën e mëposhtme jepen treguesit e infrastrukturës në nivelin e penetrimit të tyre:

	SHQIPËRIA	MALI I ZI	BOSNJE& HERCEGOVINA	GREQI	MAQEDONI	BULLGARI	RUMANI
Penetrimi internetit	14.98%	2.53%	24.28%	18.38%	13.15%	24.38%	32.36%
PC/100 përdorues	1.73	..	5.43%	9.17	22.17	6.34	12.96
Penetrimi i telefonisë celulare	48.69%	7.83%	48.25%	99.62%	69.56%	107.59%	80.45%
Penetrimi i telefonisë fikse	11.39%	3.37%	25.28%	55.52%	24.10%	31.28%	19.44%
BBand	0.01	0.25	1.02	4.38	1.79	5.01	8.18

## Indeksi i edukimit jepet si në tabelën e mëposhtme:

	SHQIPËRIA	MALI I ZI	BOSNJE& HERCEGOVINA	GREQI	MAQEDONI	BULLGARI	RUMANI
Indeksi i edukimit	0.8869	0.8911	0.8744	0.9698	0.8745	0.9262	0.9047







